



BYRO PËR ZHVILLIMIN E ARSIMIT

DORACAK PËR SHOQËRIPËR

MËSIMDHËNËSIT QË REALIZOJNË MËSIM NË
KLASËN E I, II dhe III NË ARSIMIN FILLOR
NËNTËVJEÇAR

Danica Talimxhioska
Dr Biljana Kamçevska
Liljana Samarxhiska – Panova
Ajshe Ajrullai
Olgica Naumovska
Aleksandra Mitrevska
Cvetanka Karagjuleska

Tetor, viti 2014

DORACAK PËR SHOQËRI

PËR MËSIMDHËNËSIT QË REALIZOJNË MËSIM NË KLASËN E I, II dhe III NË ARSIMIN FILLOR NËNTËVJEÇAR

I. KAHJET DIDAKTIKO METODIKE

Në edukimin dhe arsimim nëntëvjeçar, në klasën e parë, dytë dhe të tretë lënda mësimore *shoqëri* është e detyrueshme, me 1 orë në javë, gjegjësisht 36 orë në vjet.

Gjatë realizimit të temave me rëndësi të posaçme është planifikimi i arsimtarit dhe zgjedhja e përmbajtjeve në pajtim me nevojat e mësimit. Mësimin do ta planifikojë dhe realizojë në mënyrë të integruar. Lënda mësimore *shoqëri* jep mundësi më të madhe për lidhjen, gërshetimin e përmbajtjeve me lëndët e tjera, gjuhën amë, matematikën, vizatimin, edukatën muzikore, fizike dhe shëndetësore.

Në programin mësimor në pjesën e aktiviteteve dhe metodave, dominojnë vëzhgimet dhe procedurat hulumtuese dhe metoda të tjera interaktive. Vëzhgimi duhet të kuptohet si një element - pjesë përbërëse e procesit mësimor dhe si rezultat i punës edukativo-arsimore, sepse aftësia për vëzhgim zhvillohet me anë të të mësuarit. Arsimtari kur organizon vëzhgim, duhet që në të njetën kohë edhe sistematikisht t'i aftësojë nxënësit. Lidhur me aktivitetet hulumtuese janë organizuar edhe situata mësimore në të cilat nxënësi mëson me anë të zgjidhjes së problemeve. Vënia pjesë-pjesë e nxënësve në zgjidhjen e problemeve (hulumtimin) është e nevojshme në mësim pas njohjes së mjedisit.

Gjatë realizimit të qëllimeve nga programa mësimore për klasën I, II dhe III arsimtari i udhëheq aktivitetet dhe i nxit nxënësit duke parashtruar pyetje, me

qëllim që nxënësit të mund të bëhen të shkathët edhe gjatë parashtrimit të pyetjeve, në të cilat vetë do të përgjigjen me përpjekje dhe hulumtim. Zhvillimi i proceseve mendore dhe zgjidhja e problemeve është qëllimi i parë dhe themelor për mësim elementar në njohjen e mjedisit. Nxënësit kur parashtrojnë pyetje, kur japin përgjigje dhe kur i gjejnë ato, arsimtari duhet që t'ju ndihmojë, me qëllim që t'i rrisin shkathhtësitë e të menduarit, me atë që do t'ju parashtrojë pyetje të hapura. Për shembull: Çka mund të më thuash për këtë?, Në çka tjetër të përkujton?, Sqaromë çka ke bërë?, Në çka të përkujton kjo?, Çka mund të ndodhte nëse...? etj. Arsimtari duhet të parashtrojë pyetje provokuese, si për shembull: Përse?, Si?, Çka nëse?, duhet të shmangen pyetje te llojit: Çka është ajo?, Vallë a ka?, Vallë është? Nxënësve duhet t'u jepet kohë e mjaftueshme për të menduar për pyetjet para se të përgjigjen.

Format mësimore të punës duhet të përshtaten me moshën e nxënësve, nga mësimi grupor (hulumtimi dhe eksperimentimi) deri te puna individuale apo puna me çifte ose grupe.

Lojrat dhe aktivitetet luajtëse janë formë e rëndësishme në punën edukativo-arsimore për fëmijët e moshës gjashtvjeçare, ndërsa në lëndën njohja me mjedisin kanë rëndësi dominuese. Në lojrat fëmija në mënyrë specifike e përjeton dhe njeh botën që e rrethon, i paraqet interesat e tij për atë botë, e pasuron jetën emotive, meson se si të sillet në mjedis, e formon personalitetin e vet dhe në mënyrë natyrore dhe të lirë i kënaq nevojat e veta për të lëvizur dhe për aktivitet. Në njohjen e fëmijëve me mjedisin shoqëror përdoren gjithashtu edhe lojrat krijuese dhe didaktike, poashtu edhe lojrat me rregulla.

Karakteristike në lojrat krijuese është se vet fëmijët janë krijues të përmbajtjes së tyre, të qëllimit të caktuar dhe mënyrës të realizimit. Në krijimet e fëmijëve më së shumti dominojnë tema nga jeta e të riturve, kurse nxitje për lojën është vështrimi i kryer më parë i një aktiviteti të caktuar i të riturve, ngjarje apo dukuri. Në lojrat didaktike fëmijët vihen para një detyre të caktuar të cilën duhet që ta zgjidhin, duke i respektuar disa rregulla të caktuara.

Gjatë realizimit të lojës fëmijët përdorin material të ndryshëm didaktik, ku mandej kërkohet nga ata që ta rregullojnë të njejtin, të manipulojnë me të. Duke e përkëdhelur kuriozitetin spontan të fëmijëve, arsimtari do ta vështrojë fëmijën dhe do t'i zbulojë dëshirat e tij, afinitetet dhe aftësitë dhe do të krijojë kushte për zhvillim të mëtutjeshëm psikofizik dhe përparim.

Nxënësit e njoftojnë mjedisin më së miri në mënyrë të drejtpërdrejtë. Përmbajtjet që realizohen duhet të jenë *sa më aktuale*. Arsimtari duhet që t'i

shfrytëzojë ngjarjet dhe situatat aktuale në klasë dhe t'i përfshijë në punën me fëmijët. Në atë mënyrë nxënësit do të mundën më lehtë ta ndërlihin përvojën, të ndodhur jashta lokaleve të shkollës, me mësimin. Mësimi do të jetë më i lehtë për nxënësit, nëse arsimtari përmbajtjet i ndërlihdë sipas kuptimit. Gjithmonë gjatë lidhjes së tyre duhet të kihet parasysh qartësia e asaj çka është qëllimi kryesor dhe kuptimi i mësimin dhe çka në të flitet.

Klasa për nxënësit duhet të jetë hapësirë me interes, e pajisur me përmbledhje, mjete ndihmëse, bibliotekë, kate përpunuese dhe punime të nxënësve. Klasa të jetë mjedis stimulues, e pasur me materiale të ndryshme për të mësuar të cilat kanë qasje për të gjithë nxënësit.

Roli i arsimtarit është tepër i rëndësishëm. Ai paraqet burim i njohurive dhe iniciator i ngjarjeve. Arsimtari udhëheq me aktivitetet, nxitë, koordinon, hulumton, vlerëson, ndihmon dhe është burimi më i pasur i informacioneve. Arsimtari vazhdimisht duhet të krijojë mjedis ku sëbashku me nxënësit do të ndihmojë në zhvillimin e aftësive të tyre, të mund të mendojnë në mënyrë kritike, të hulumtojnë dhe të përshkruajnë drejt. **Thelbi i të mësuarit** nuk qëndron në të mbajturin mend të ngjarjeve, por zhvillimin e aftësive dhe shkathtësive. Kur arsimtari vazhdimisht ju jep nxënësve fakte, ajo mund të shkaktojë fundin e kureshtjes së tyre.

Shembujt e propozuar të aktiviteteve duhet të realizohen përmes formave vijuese të punës: formës së përbashkët, grupore, individuale dhe formës në çifte – tandem. Gjatë planifikimit të aktiviteteve në mësim, format organizative të punës ndryshohen dhe plotësohen.

Metodat mësimore kanë të bëjnë me aktivitetin e nxënësve dhe aktivitetin e arsimtarit në procesin mësimor dhe e sigurojnë aktivitetin dhe interaksionin ekzistues ndërmjet tyre.

Në shembujt e përpunuar të aktiviteteve përfshihen metodat vijuese:

- Metoda e lojës;
- Metoda e mbikëqyrjes;
- Metoda e hulumtimit;
- Metoda gojore (monolog, dialog dhe metoda e diskutimit);
- Metoda e punës me tekst (tekste, lista pune dhe detyra individuale);
- Metoda e tregimit (varg fotografish, lodra, aplikacione etj);
- Metoda ilustruese;
- Metoda e punës praktike.

II. PËRCJELLJA DHE VLERËSIMI I ARRITJEVE TË NXËNËSVE NË KUADËR TË LËNDËS

Përcjellja dhe vlerësimi i nxënësve bëhet me të përshkruar. Mënjanohet i theksuari faktografik, vërtetimi dhe vlerësimi i njohurive. Përcjellja e arritjeve të nxënësve do të jetë individuale, siç planifikohen edhe aktivitetet, të cilat janë të përshtatura sipas aftësive individuale të nxënësve. Në fillim të vitit shkollor, arsimtari duhet ta shqyrtojë gjendjen iniciale (fillestare), paranjohuritë dhe shkathtësitë e mjedisit natyror dhe shoqëror. Kjo është më se e detyrueshme ta bëjë para përpunimit të temës dhe përmbajtjes së re mësimore, për planifikim të mësimin.

Në përgatitjen e orës, për arsimtarin rëndësi ka plani për vlerësim, gjatë të cilit arsimtari duhet të planifikojë:

- cilat aftësi dhe shkathtësi do t'i vlerësojë
- cilët fëmijë do t'i vlerësojë (është e pamundur që në çdo orë të mblidhen informacione për të gjithë nxënësit e klasës).
- Me çfarë qëllimi do ta bëjë notimin, dhe cilat veprime dhe instrumente do të përdoren.

Përcjellja, kontrollimi dhe vlerësimi reciprokisht janë aktivitete të lidhura. Nuk ka vlerësim pa përcjellje dhe kontrollim, e as përcjellja dhe kontrollimi nuk mund pa vlerësimin. Të gjitha këto aktivitete në shkollë doemos të shërbejnë, në radhë të parë për të stimuluar zhvillimin e nxënësit.

Kontrollimi diagnostik zbatohet kur arsimtari për herë të parë takohet me një grup të caktuar të nxënësve (në klasën e I) ose para fillimit të përpunimit të përmbajtjeve të reja. Njohja e gjendjes fillestare është bazë për parashikimin e mundësive të nxënësve dhe për planifikimin e punës.

Kontrollimi formativ bëhet në vazhdimësi gjatë tërë vitit shkollor paralelisht me realizimin e procesit mësimor. Notimi formativ llogaritet për bartje të komponentës të konceptit të vlerësimit analitik përshkrues. Kontrollimi formativ ka për qëllim të jep informatë kthyesë në procesin e mësimin dhe mësimnxënies.

Qëllimi i tij përfundimtarë është që të angazhohen nxënësit në vetëkontrollim dhe vetëvlerësim. Gjatë kontrollimit formativ dhe vlerësimit arsimtari duhet të mbajë llogari për punën në vijim:

1. parashtrimi i qëllimit të të mësuarit që do ta ketë të qartë edhe fëmija (të dijë pse diçka punon, çka dëshiron të dijë, pse ajo është e rëndësishme etj);

2. mënyrat e përcjelljes se si fëmija mendon, si zgjidh probleme, cilat lloje të gabimeve i bën;
3. reagime, informata kthyesë të arsimitarit që do ta orientojnë të mësuarit e fëmijës (kërkimi i sqarimit se si ka ardhur deri te ajo, pse ashtu mendon, udhëzim se çka mund të provojë, vetë notim çka mendon se mirë ka bërë, e çka jo, parashtrimi i qëllimeve afatshkurtër dhe afatgjatë së bashku me nxënësit) dhe
4. informimi i prindit për njohurinë e vlerësimit formativ dhe dhënia e udhëzimeve se si ato duhet të punojnë me fëmijën.

Në përcjelljen, kontrollimin dhe vlerësimin formativ me rëndësi është cilësia e informatës kthyesë që ia jep arsimtari nxënësve dhe prindërve. Informata kthyesë cilësore i përmbush nevojat e nxënësit, sepse e udhëzon dhe i ndihmon ta arrijë atë nivel për të cilin posedon potencial.

Gjatë përcjelljes dhe vlerësimit arsimtari kujdeset se si nxënësit:

- I kuptojnë udhëzimet dhe i respektojnë kur punojnë në grup apo pavarësisht;
- Si vështrojnë, si gjinden në situatë të caktuar, si e kryejnë punën, në mënyrë sipërfaqësore ose në hollësi;
- I respektojnë mendimet e të tjerëve, nuk flasin kur flet tjetri, i tregojnë mendimet e tyre, janë të përgatitur t'i ndryshojnë mendimet e tyre.

Çfarë rezultati arrijnë nxënësit (vizatime, fleta pune, përgjigje me gojë, krijime figurative etj.).

Për përcjelljen dhe kontrollimin e të arriturave të nxënësve, arsimtari zbaton një numër të madh metodash, procedurash, teknika dhe instrumente. Për përcjellje dhe kontrollim të nxënësve shfrytëzohen: mbikëqyrja, biseda, të gjitha llojet e të shprehurit gojorë, kontrollimi praktik dhe me shkrim. Për grumbullimin, regjistrimin e të dhënave dhe informatat e sjelljes, përgjigjet dhe përpunimet e nxënësve shfrytëzohen: pyetësorë, fleta për kontrollim, çek lista, shkallë gjykuese.

Me rëndësi është edhe kontrollimi i mendimit të nxënësit. Për këtë arsye është e nevojshme të planifikohen detyra për këtë. Në veçanti për këtë moshë është zhvillimi i bisedës, që përfshin parashtrimin e pyetjeve të hapura dhe marrja e përgjigjes. Gjithashtu, vizatimi dhe zbatimi i vizatimit në mësim është mënyrë e mirë që fëmijët t'i shprehin mendimet e tyre, vetë të sqarojnë ose në bisedë me arsimtarin.

Për përmbledhjen e të dhënave për të arriturat e nxënësit dhe përshkrimin e përparimit të nxënësve, arsimtari më së shpeshti përdor: shënime anekdotike, dosje

të nxënësve, shënime analitike, komente rrjedhëse dhe shënime analitike komplekse. Shënim i tillë i kompletuar është nota përfundimtare vjetore.

III. SHEMBUJ TË AKTIVITETEVE SIPAS TEMAVE MËSIMORE PËR KLASËN E I -rë

TEMA: UNË DHE TË TJERËT

Shembulli 1: Kush jam unë

Qëllimet: Nxënësi/nxënësja t'i dijë të dhënat kryesore për veten.

Mjetet: top, kartona të vegjël ku janë vendosur shkronjat e para të disa emrave të fëmijëve apo shenja të tjera (lule, flutur, top) për ata fëmijë që nuk e njohin shkronjën e parë të emrit të tyre.

Nocionet: emri, nxënësi, mbiemri, kush jam unë

Vendi i realizimit: klasa

Rrjedha e aktiviteteve:

AKTIVITETET HYRËSE

Nxënësit janë të renditur në rreth dhe po luanë me top lojën “Kape topin dhe thuaje emrin tënd”. Së pari arsimtari e thotë emrin e vet dhe sqaron vallë i pëlqen dhe përse. Pastaj çdo nxënës e thotë emrin e vet, vallë i pëlqen emri i vet dhe pse dhe nëse ndonjërit nuk i pëlqen emri i vet tregon si dëshiron të quhet. Gjatë hudsones së topit kërkohet nga nxënësit që një nga një, ta thonë emrin e tyre me zë të ulët, mandej me zë të lartë, ta këndojnë emrin e tyre dhe ta paraqesin atë duke i lëvizur duart.

AKTIVITETET E MËSIMDHËNIES-MËSIMNXËNIES

Pas njohjes me njëri tjetrin, kërkohet nga nxënësit që të zbulojnë vallë në klasën e tyre ka nxënës me emër të njejtë apo emrat ju fillojnë me të njejtën shkronjë. Nxënësit marrin kartona në të cilat shohin shkronjën e parë të emrit të tyre, pranë shkronjës është vendosur edhe një shenjë (lule, diell, zog) për ata fëmijë të cilët nuk e njohin shkronjën e parë të emrit të tyre dhe nga ata kërkohet që çdonjëri ta gjejë të njejtën shenjë. Kur të gjinden, ata grupohen varësisht nga emrat në klasë dhe shkronjën fillestare. Në grup i thonë emrat dhe bisedojnë.

Nxënësit janë të ulur në tepih dhe prej tyre kërkohet që të prezantohen ashtu që ta thonë emrin e tyre me zë dhe qartë e mandej emrit t'i shtojnë diçka të bukur. Shembullin e jep arsimtari për emrin e vet dhe për disa emra të tjerë që nuk janë në klasë. Për shembull, Vesa – e lumtur dhe e gëzuar, Suzana – e ndritshme si dielli etj. Thëniet e tyre shkruhen apo inçizohen në kasetofon.

AKTIVITETET EVALUATIVE

Nxënësit punojnë nga një bexh prej letre – Ky/Kjo jam unë

Treguesit e arritjeve:

i din të dhënat themelore për veten, emrin dhe mbiemrin e tij mund ta thotë vet.

TEMA: UNË DHE TË TJERËT

Shembulli 2: Emocionet e mia

Qëllimet: Nxënësi/nxënësja të mundet të njoh llojet e emocioneve dhe thot ndjenjat te vetvetja dhe te të tjerët.

Mjete: kukulla në kuti, fotografi me persona ku janë treguar përjetimet e tyre të emocioneve, kasetofon

Nocione: emocione, dashuri, gëzim, dhimbje, frikë

Vendi i realizimit: klasa

Rrjedha e aktiviteteve:

AKTIVITETET HYRËSE

Fëmijët janë të ulur në gjysëmrrreth dhe para tyre paraqitet një shfaqje e shkurtër “Kutia e gëzuar dhe e lumtur”.(shikoe tekstin në vazhdim).

AKTIVITETET E MËSIMDHËNIES-MËSIMNXËNIES

Pas shfaqjes zhvillohet një bisedë për përmbajtjen me pyetjet: Çfarë fytyre ka pasur kutia e larme?, Çfarë fytyre ka pasur kutia e rëndomtë?, Pse kutia e larme ka qenë e gëzuar?, Pse kutia e rëndomtë ka qenë e mërzhitur?, Çfarë ka ndodhur me kutinë e rëndomtë kur fëmijët i kanë kënduar këngë asaj?, Pas bisedës nxirren fotografitë që gjenden nëpër kuti dhe bisedohet për to. Çdo nxënës merr nga një foto dhe sqaron se

çfarë ndodh në të, çfarë emocione janë treguar aty. Në foto ka persona që përjetojnë gëzim dhe e shprehin atë, apo dhe dhimbje, dashuri dhe frikë.

Luhet loja “Rrethi i emocioneve”, Arsimtari tregon ngjarje te ndryshme, kurse nxënësit me trupin dhe fytyrën e tyre e shprehin emocionin, duke luajtur në rreth. Për shembull arsimtari tregon: “E humba kukullën, si ndjehem tani?”, “Jashtë bie shi, fryn erë, nuk ka rrymë, ndërsa unë si po ndjehem?”

AKTIVITETET EVALUATIVE

Luajtja e lojës “Pantomima” shprehja e emocioneve nëpërmjet gjesteve, pantomima (një nxënës shpreh emocione, kurse të tjerët e qëllojnë).

Në fund arsimtari lëshon muzikë të ndryshme ndërsa nxënësit e dëgjojnë dhe bëjnë lëvizja varësisht prej asaj se si e ndjejnë muzikën.

Treguesit e arritjeve

Nxënësi/nxënësja **tregojnë se njohin dhe i thonë** emocione-gëzim, yemrim, frigë, dashuri – përmes lëvizjes së trupit, shprehjeve të fytyrës dhe verbale.

Kutia e gëzuar dhe ajo e mërzitur

Në skenë janë paraqitur dy kuti. Njëra kuti është e mbështjellur me letër të kaltërt me yje dhe me fytyrë të qeshur. Kutia e dytë është mbështjellë me letër të rëndomtë me fytyrë të vizatuar dhimbshëm, kurse gjysma tjetër është e vizatuar me fytyrë të qeshur. Në të dy kutitë gjenden fotografi në të cilat janë paraqitur emocione të caktuara. Takohen të dy kutitë dhe zhvillohet bisedë midis tyre.

Kutia e parë: Tungjatjeta kuti, mikja ime. Kush ta dhuroi fustanin me yje?

Kutia e dytë: Në mbrëmje shetitesha nëpër qiell dhe yjet ma qëndisën fustanin.

Kutia e parë: Ku po shkon mike e dashur?

Kutia e dytë: Po shkoj te shoqet e mia, te fëmijët dhe ju dërgoj fotografi të gëzueshme.

Kutia e parë: Përse je aq e gëzuar?

Kutia e dytë: Po, kam shumë fotografi, vizatime të larme dhe këngë të ndryshme.

Kutia e parë: A më tregon një këngë?

Kutia e dytë: E pyeta fluturën e vogël:

- Vallë bari merr frymë?
- Ai më tha: “Merr frymë, merr dhe në erë i gëzuar luhatet”.

Kutia e parë: Sa je e gëzuar, fëmijët të duan, yjet të dhurojnë, kurse mua askush nuk më do, s'kam asnjë fotografi dhe ilustrim, nuk di asnjë këngë.

Kutia e dytë: Mos qaj, mos u mërzit. Unë dhe fëmijët do të të mësojmë shumë vjersha dhe këngë, apo fëmijë? Ajde të këndon një këngë që ta gëzoni kutinë, ndoshta edhe ty do të mbushesh me ilustrime dhe fotografi. (Fëmijët këndojnë, kurse kutia e parë rrotullohet dhe menjëherë ngrihet e gëzuar dhe e mbushur plot me fotografi).

Kutia e parë: Oh, po ndihem çuditshëm. Diçka më vlon në kokë.

Kutia e dytë: Të shoh çka ka ndodhur në kokën tënde? (kutia fshehurazi shikon), Uraa tani je e mbushur plot me fotografi dhe vizatime. Ajde t'jua tregojmë fëmijëve. (tekst i përshtatur për nevojat e aktivitetit)

TEMA: UNË DHE TË TJERËT

Shembulli numër 3: Shoqërim

Qëllimet: Nxënësi/nxënësja të zhvillojë shprehje për sjellje me kulturë;

- të njihet me nocionin shoqërim.

Mjetet: flomasterë, hamer, fotografi (vizatime) ku janë prezantuar dy situata dhe sjellje të ndryshme të fëmijëve, letër për vizatim, ngjyra druri.

Nocionet: shoqërim.

Vendi i realizimit: klasa.

Rrjedha e aktivitetit

AKTIVITETET HYRËSE

Arsimtari i udhëzon nxënësit që me vëmendje ta dëgjojnë këngën „Shoqërim” dhe e lëshon atë. Pasi që nxënësit do ta dëgjojnë këngën, arsimtari i pyet se vallë ju pëlqen dhe kujt i dedikohet teksti i këngës.

Zhvillohet bisedë me temë: „Çka është shoqërimi?”. Secili nxënës tregon për shokun ndërsa arsimtari i shënon në hamer.

AKTIVITETET E MËSIMDHËNIES-MËSIMNXËNIES

Pas bisedës me nxënësit arsimtari paraqet dy fotografi (mund të përgatisë dhe prezantim me temë: „shoqërimi”) dhe i nxit nxënësit t'i shikojnë mirë dhe të tregojnë se çka vërejnë në fotografi, ndërsa madje



veçanërisht t'i kushtojnë vëmendje asaj se cilët veprime të figurave të prezantuara sipas tyre janë të mira ndërsa cilët janë të këqija. Nxënësit e marrin fjalën dhe flasin për situata në fotografi.

Pas bisedës arsimtari trillon tregim sipas fotografive, ndodhi që i ndodh ndonjë personi i cili e ka të njohur mirë. Përmes tregimit arsimtari do të flet për shoqërimin, duke i theksuar veprimet dhe sjelljet. Biseda për shoqërimin vazhdon. Nxiten nxënësit t'i përgjigjen pyetjeve (për shembull: Cilët janë shokët Tuaj në shkollë?; Vallë pse ato janë shokët Tuaj?; Si veprojnë shokët e mirë?; Ma çka mund të vërejmë se cili është shok i mirë?; Çka duhet që të jesh shok i mirë?) të japin përshtkrim të tipareve të një shoku të mirë.

Arsimtari i thërret nxënësit që të ndahen në çifte dhe secili të ndalet me shokun e tij. Kështu e këndojnë këngën në çifte:

„Vallëzo me shokun tënd,
Njëra dorë, tjetra dorë,
Vallëzo me shokun tënd.” (Fëmijët ngjiten për dore)
„Përkulu, qeshu,
Mandej shpejt rrotullohu.
Njëra këmbë, tjetra këmbë
„Përkulu, qeshu,
Mandej shpejt rrotullohu.



AKTIVITETET EVALUATIVE

Në fund nxënësit ulen në vendet e veta, marrin nga një fletë për vizatim, marrin ngjyra prej druri dhe secili e vizaton shokun e tij më të mirë.

Treguesit e të arriturave:

Nxënësi/nxënësja mund që me fjalët e veta të sqarojë se çka është shoku/shoqja, shoqëria, jep shembuj për sjelljen kulturore me tjerët, mund të jap shembull për sjelljen e pranueshme nga shoku, mund të jap shembull për sjelljen e papëlqyeshme të shokut të mirë.

TEMA: SHKOLLA IME

Shembulli numër 4: Klasa ime

Qëllimet: Nxënësi/nxënësja njohje me klasën – katet, lojrat, njohje dhe dallim të kateve sipas shenjave të tyre, zhvillim i raportit të drejtë të kah mjetet në klasë dhe kujdes ndaj tyre.

Mjetet: fotografi, shenja për këndet lojra prej këndevee, 6 letra – fotografi me shenja për këndet, 2 harta.

Vendi i realizimit: Klasa

Përgatitje paraprake

Lexim i vizatimit “Markoja dhe shokët”, lojra nëpër kate sipas dëshirës së fëmijëve, bisedë për lojrat, për raportin dhe kujdesin ndaj tyre.

Rrjedha e aktiviteteve

AKTIVITETET HYRËSE

Nxënësve ju sqarohet se do të luhet loja “Udhëtojmë, udhëtoj”. Ata renditen si “tren” dhe “udhëtojnë nëpër klasë”.

AKTIVITETET E MËSIMDHËNIES-MËSIMNXËNIES

Arsimtari i lut nxënësit të rradhiten në kolonë nga dy dhe ju sqarohet se do të udhëtojnë nëpër klasë dhe se do të njihen me vende të caktuara – kënde. Udhëtohet nga një kënd në kënd tjetër , shikohen shenjat e këndeve me të cilat përfaqësohen këndet dhe emërohen aktivitetet e paraqitura në të. Nga nxënësit kërkohet që të vërtetojnë nëse në katin ku qëndrojnë gjendet ndonjë lojrë e paraqitur në fotografinë e madhe. Lojrat emërtohen dhe udhëtimi vazhdon deri në katin tjetër. Ashtu loja vazhdon nëpër të gjithë katet në klasë: 1. në mënyrë konstruktive, 2 familjare, 3. artistike, 4. bibliotekiste, 5. si komunikacion dhe 6. në mënyrë shkencore. Në dy kënde arsimtari ka vendosur lojra të thyera dhe e pyet të tregojnë se çka mendojnë, kush i ka thyer, si ka ndodhur, pse i ka thyer , a janë të bukura kur janë të thyera, çka të bëjmë me lojrat e thyera (të propozojnë zgjedhje). Nëse i thyejmë të gjitha lojrat çka do të ndodh?

AKTIVITETET EVALUATIVE

Pas përfundimit të udhëtimit nëpër klasa nxënësit ndahen në 6 grupe. Secili grup tërheq letra-fotografi për udhëtim në të cilën qëndron vendi ku duhet grupi të udhëtojë (shenja e këndit). Nxënësit duhet ta lexojnë letrën, të udhëtojnë deri te kati, të sjellin nga një lojrë dhe ta gjejnë porosinë e fshehur-hartën e pasurisë. (Harta do të vendoset në kuti me qëllim që nxënësit të mundën lehtë ta gjejnë). Fitues do të jetë ai grup i cili i pari do ta përfundojë udhëtimin, do ta sjellë lojrën dhe do ta zbulojë hartën. Grupet fituese (do të vendosen dy harta) duhet ta lexojnë

hartën dhe ta gjejnë pasurinë (në hartë janë vizatuar shenjat e këndeve ku nxënësit duhet të qëndrojnë dhe për ta sjellë ëmbëlsirën duhet të zbulojnë se në cilin kat ajo gjendet, kurse në këtë do të ndihmojë mjeti i vizatuar në hartë që është i atij kati).

Treguesit e arritjeve:

Nxënësi/nxënësja mund ti njoh, emëroj dhe dalloj këndet sipas shenjave, mund të gjindet në këndet me kërkes nga arsimtari, mund të numëroj shembuj për raporte të drejta me gjërat në klasë dhe kujdes për ato.

Gjindshmëria në katet sipas kërkesës së arsimtarit

Shtojcë:

1. Harta – shënues për katet, Fletë pune nr.1

TEMA: SHKOLLA IME

Shembulli numër 5: Rregullat e sjelljes

Qellimet: Nxënësi/nxënësja

- të marrin pjesë në sjelljen dhe aplikimin e rregullave në klasë dhe në shkollë.
- ti respektoj rradhën e aktiviteteve dhe të kuptoj se rregullat janë të nevojshme për jetën dhe punën në klasë.

Mjetet: fotografi nga insitucione të ndryshme (spital, teatër, kinema, shitore, postë) fotografia në të cilën janë treguar rregulla të caktuara të sjelljes në klasë (sjellje e drejtë dhe jo e drejtë), pano apo hamer për theksimin e rregullave, pajisje për vizatim (laps, fllomaster, pastel i thatë), letër për vizatim dhe kasetofon.

Nocione: rregulla, përgjegjësi.

Vendi i realizimit: Klasa

Rrjedha e aktiviteteve

AKTIVITETET HYRËSE

Shëtitje nëpër shkollë dhe të vërejturit e atmosferës gjatë kohës së orëve, gjatë pushimit, në obor, korridore dhe nëpër klasët e tjera.

AKTIVITETET E MËSIMDHËNIES-MËSIMNXËNIES

Arsimtari në bazë të asaj që nxënësit e kanë vërejtur gjat shëtitjes yhvillon bisedë me nxënësit për rregullat që duhet respektohen në klasë. Nxiten nxënësit që të mendojnë për atë se si të sillen në shkollë dhe si të sillen në klasë. Çdo fëmijë shpreh rregulla të veçanta dhe arsimtari i shënon apo i inçizon në kasetofon. Mandej rregullat e shprehura grupohen dhe theksohen nëpërmjet vizatimeve. Vizatimet mund t'i përgatisë arsimtari apo nxënësit vetë t'i vizatojnë rregullat (për shembull: vizatim i fëmijës që mbledh mbeturina, fëmija që i rendit lojrat, fëmijë të renditur për kafjall). Theksohen edhe rregullat në klasë.

AKTIVITETET EVALUATIVE

Në fund të orës nxënësit përkujtohen për atë se si së bashku i sollën rregullat dhe bisedohet për rëndësinë e çdo rregulle dhe nevoja për respektimin e saj.

Treguesit e arritjeve:

Nxënësi/nxënësja marrin pjesë në sjelljen e rregullat e sjelljes në klasë, mund të numroj disa nga rregullat e vendosura dhe mund të sqaroj pse duhet të respektohen rregullat e vendosura.

TEMA: SHKOLLA IME

Shembulli nr.6: Shkolla ime

Qëllimet: Nxënësi/nxënësja ta njohin mjedisin e tyre shkollor.

Mjetet mësimore: hamer, aplikacione me temë: Shkolla (shkolla, nxënës, libra, nxënëse), ngjitës, material ndërtimor i imët dhe i madh nga këndi i ndërtimtarisë.

Nocionet: shkollë, arsimtarë, nxënës, nxënëse, klasë.

Vendi i realizimit: klasë, shkollë.

Rrjedha e aktivitetit

AKTIVITETET HYRËSE

Nxënësit janë të ulur në tepih në rreth dhe arsimtari i lut të kenë kujdes, ta dëgjojnë dhe ta qëllojnë gjëegjëzën që ai e ka lexuar. Arsimtari lexon:

„Aty njohuritë bëhen realitet,

Dhe në diçka që vetëm ëndërrohet.



Nga Shtatori deri në Qershor para secilës orë,

Bie zilja e shkollës.” (shkolla)

AKTIVITETET E MËSIMDHËNIES-MËSIMNXËNIES

Pasi që nxënësit do ta qëllojnë gjëgjëzën, arsimtari e ngjet aplikacionin e shkollës në hamerin e përgatitur. Mandej parashtron pyetje për të cilat nxënësit japin përgjigje: Vallë pse këtë ndërtesë e quajmë shkollë?; Kush mëson aty?; Prej se mësohet?; kush i mëson nxënësit? Pas secilës pyetje arsimtari e nxjerr aplikacionin adekuat dhe e ngjet në hamer.

Aplikacionet



Pas bisedës nxënësit së bashku me arsimtarin bëjnë një shëtitje rreth shkollës. Ata e vështrojnë oborrin e shkollës, ndërtesën e shkollës, hapësirat aty. Përderisa vështrohet shkolla, arsimtari i pyet nxënësit: Çka mendoni, Vallë shkolla jonë ka emrin e vet?; Vallë secila shkollë ka emrin e vet?; Vallë? Vallë dikush e din se si quhet shkolla jonë?; Për çka shërbejnë hapësirat e shkollës?; Vallë pse në shkollë ka hapësira të ndryshme? Arsimtari i nxit nxënësit të vërejnë se çka është e ndryshme ndërsa çka është e ngjashme ndërmjet hapësirave në shkollë.

Pas realizimit të mbikëqyrjes së shkollës dhe njohja me hapësirat e tyre nxënësit kthehen në klasë. Ndahen në dy grupe dhe secili grup merr detyrë që ta „ndërtojë” shkollën me hapësirat e saj me materialin ndërtimor nga këndet. Gjatë „ndërtimit” nxënësit merren vesh, ndihmojnë dhe përkrahen. Në fund grupet i prezantojnë punimet e tyre.

AKTIVITETET EVALUATIVE

Në fund të orës nxënësit i prezantojnë shkollat e tyre të ndërtuara

Treguesit e arritjeve:

Nxënësi/nxënësja mund me fjalët e veta të sqarojë se çka është shkolla, arsimtarë, arsimtare, nxënës, nxënëse, përshkruan se çka ka në klasën e tyre, e tregon emrin e shkollës së vetë.

TEMA: SHTËPIA IME

Shembulli nr.7: Familja ime

Qëllimet: Nxënësi/nxënësja ti rrespektoj të afërmit në familje dhe të zhvillim i ndjenjës së përkatësisë për familjen.

Nocione: shtëpia, familja, anëtarë.

Mjetet: albume familjare, enciklopedi, DVD, mbështetëse të vogla për vizatim, laps, mbështetëse prej hameri-shtëpi, ngjitëse.

Vendi ku mbahet: klasa

Rrjedha e aktiviteteve:

AKTIVITETET HYRËSE

Zhvillohet bisedë me temë: “Çka është familja?, Kush e përbën familjen?”, Çfarë familjesh ekzistojnë?, (për njerëzit, kafshët). Thëniet e marra nga nxënësit inçizohen apo shënohen.

AKTIVITETET E MËSIMDHËNIES-MËSIMNXËNIES

Nxënësit shohin albume familjare, enciklopedi, dhe bisedojnë për familjet e tyre – për dashurinë, si shprehet ajo, sa anëtarë ka familja e tyre. Pas bisedës do të luhet loja: “Familja ime ka ... anëtarë”. Nxënësit do t’i emërtojnë anëtarët e familjes së tyre, do t’i vizatojnë në mbështetëset e vogla dhe do të duhet që këtë ta ngjisin në vendin e caktuar në mbështetësen e shtëpisë së madhe.

Pas përfundimit të lojës zhvillohet një bisedë lidhur me të dhënat e fituara dhe konstatohet se familjet kanë numër të ndryshëm të anëtarëve në familje, domethënë janë të ndryshëm dhe se anëtarët në familje duhet ta kuptojnë njëri tjetrin, duan dhe respektojnë.

AKTIVITETET EVALUATIVE

Në fund të orës nxënësit me fjalë dhe me gjeste shprehin dashurinë ndaj anëtarëve të familjes së vet. (p.sh. si do ti thash mamit se e do? Si do ti tregosh babit se e do? e tj.)

Treguesit e arritjeve:

Nxënësi/nxënësja i emërtojnë anëtarët e familjes më të ngushtë, babai, nëna, vëllai, motra dhe mundet me fjalë të veta të spjegoj si duhen dhe respektohen antarët e familjes së tyre.

Shtojca: Fletë pune nr. 2

TEMA: SHTËPIA IME

Shembulli nr.8: Detyrimet e mia në shtëpi

Qëllimet: Nxënësi/nxënësja të njihen me rregullat e sjelljes në familje dhe rolet.

Mjetet: fotografi të mëdha me aktivitetet e paraqitura në shtëpi (fëmija nxjerr lule, fëmija rregullon lojrat, fëmija luan në kompjuter, kurse dhoma nuk është e rregulluar), zarf me fotografi të vogla ku janë paraqitur aktivitete të ndryshme të fëmijës në shtëpi, hamer, fllomasterë.

Nocione: dhoma ime , detyrime.

Vendi ku mbahet: klasa

Rrjedha e aktiviteteve:

AKTIVITETET HYRËSE

Arsimtari e lexon tregimit: “Dy shoqe” (shtojcë) dhe bisedë për përmbajtjen e tij. Dhe zhvillon bisedë me për nxënësipër përmbajtjen e tregimit. Parashtron pyetje: Cilat ishin veprimet e Leonës?, Cilat ishin veprimet e Anikës?, Cili ka vepruar drejt dhe përse?, Bëhet përpjekje që të gjithë nxënësit të përfshihen në bisedën për tregimin.

AKTIVITETET E MËSIMDHËNIES-MËSIMNXËNIES

Para nxënësve parashtrohen fotografi nga situata të ndryshme të fëmijës në shtëpi. Zhvillohet bisedë për to dhe përcaktohen veprimet e mira dhe ato të këqija. Nga nxënësit kërkohet që të japin propozim – të shpikin shenja me të cilat do t’i prezantojnë veprimet e mira dhe ato të këqija. Fëmijët mendojnë dhe fitohen ide të ndryshme për veprimet (psh. për veprim të mirë – lule, diell, kurse për veprim të keq – lule e shkarravitur etj.).

Luhet loja “Thuaj cilat veprime janë të këqija apo të mira”. Në zarf janë të vendosura fotografi në të cilat tregohen aktivitete të ndryshme. Çdo nxënës tërheq nga një fotografi, e shikon, mandej tregon vallë veprimi në foto është i mirë apo i keq dhe mandej e vendos në vendin përkatës të hamerit. Nxënësi duhet të tregojë se veprimi është i mirë apo i keq dhe ta vendosë në vendin e duhur (hamer që është i ndarë në dy pjesë dhe ka shenja për veprim të mirë apo të keq). Nga nxënësit e tjerë kërkohet që ta përcjellin punën në mënyrë aktive dhe të tregojnë se a është mirë. Në atë mënyrë nxënësit i kontrollojnë njohuritë e tyre dhe njihen poashtu edhe me situata të tjera, mendojnë në mënyrë kritike dhe shprehin idetë e veta, kur nuk pajtohen me mendimin e shokëve.

AKTIVITETET EVALUATIVE

Nxënësit vizatojnë disa rregullat të sjelljes në shtëpi dhe pastaj i tregojnë dhe i sqrojnë para nxënësve të tjerë.

Treguesit e arritjeve:

Nxënësi/nxënësja bën numërimin e disa detyrimeve në shtëpi dhe mundet me fjalë të veta të thotë disa rregulla të sjelljes dhe disa role të anëtarëve të familjes.

Dy shoqet

Të gjithë e lëvdojnë Lenkën:

- Ajo është e bukur. Ajo është e vyeshme.

Mandej shtojnë:

- Edhe Anka është e vyeshme.

Lenka dhe Anka janë shoqe të mira. Sëbashku i punojnë detyrat e shtëpisë dhe sëbashku vizatojnë me ngjyra uji.

Dje Lenka tha.

- Nënë e dua më shumë se çdogjë.

- Edhe unë – tha Anka.

Mandej shkuan çdonjëra në shtëpinë e vet.

Kur arritën në shtëpi, Lenka qysh te dera tha:

- Nënë shumë të dua! Më lejo të të puth!

Nëna e saj punonte nëpër shtëpi, kurse Lenka shkante pas saj dhe fliste:

- Nënë përsëri do të të puth! Vallë dreka së shpejti do të jetë gati?

Kur Anka arriti në shtëpi, e përshëndeti nënën e saj, e morri fshesën, e fshiu pluhurin në kuzhinë dhe i ndihmoi nënës së saj në përgatitjen e drekës...

Ivan Harallampiev



I ujis lulet



I ndihmoj nënës gjatë përgatitjes së drekës



Pas lojës i ngre lojrat



Nëna i lan enët, kurse unë luaj

TEMA: SHTËPIA IME

Shembulli nr. 9: Festat në familje

Qëllimet: Nxënësi/nxënësja t'i njeh dhe t'i respektojë festat familjare të fëmijëve nga mjedisi i vet (nga bashkësitë e ndryshme etnike).

Mjetet mësimore: fotografi të festave, hamer, ngjitës, videoprezantim, letër për vizatim, ngjyra dylli.

Nocionet: festa, manifestime.




Vendi i realizimit: klasa

Rrjedha e aktiviteteve


AKTIVITETET HYRËSE

Nxënësit njihen me lojën, „Asocijimi“. Ata e luajnë lojën dhe gradualisht e zbulojnë nocionin *festë*.

Varianti i parë

e gjelbër	e bardhë	e ëmbël
e lartë	laramane	laramane
e zbukuruar	e zier	qirinj
		

Varianti i dytë

e gjelbër	tepsi	e ëmbël
e lartë	kore dhe arra	laramane
e zbukuruar	ëmbël	qirinj
bredh 	bakllavë 	tortë 

AKTIVITETET E MËSIMDHËNIES-MËSIMNXËNIES

Pas zbulimit të nocionit *festa* arsimtari nxit bisedë me nxënësit duke vendosur pyetje, si për shembull: Çka është festa? Si është ajo ditë? Me çka festa dallohet nga ditët tjera? Si është disponimi i kohës së festave? etj.

Arsimtari i njeh nxënësit me aktivitetin me të cilin nxënësit duhet në veçanti ta përfundojnë fjalinë: „Kur do të them festë mendojë në” (ëmbëlsirë, vizitë te tezyja ime, fotografim, veshje e mirë, diskonim i mirë).

Në aktivitetin vijues arsimtari emëron disa festa që manifestohen në tërë botën, ndërsa nxënësit duhet të ngrihen kur do ta dëgjojnë emrin e festës që festohet në shtëpinë e tyre.

Arsimtari i tregon, një nga një, fotografitë e të cilave janë prezantuar festa të ndryshme dhe manifestime, flet për ata dhe i ngjet në hamerin e përgatitur paraprakisht. Mandej edhe nxënësit flasin për përvojat e tyre nga manifestimet e tyre familjare, por edhe për përvojat kur kanë vizituar familje tjera kur janë festuar festat e tyre.





Në vend të fotografive arsimtari mund ta tregojë videoprezantimin e përgatitur për festa të ndryshme dhe manifestime, me çka në secilin sllajd për secilën festë theksohet simboli i festës (si psh., Viti i Ri- bredhi, Pashkët – vezë e zbukuruar, ditëlindje – tortë, Ditë e faljes së gabimeve – vezë në rrjetë, Kolendrat – strajcë, Bajrami – bakllava etj). Mandej edhe nxënësit flasin për përvojat e tyre nga manifestimet e tyre familjare, por dhe për përvoja kur kanë vizituar familje tjera kur janë festuar festat e tyre.

AKTIVITETET EVALUATIVE

Në fund secili nxënës/nxënëse me ngjyra dylli e vizaton festën që manifestohet në familjen e tij/saj, ndërsa kush e dëshiron më tepër.

Treguesit e të arriturave

Nxënësi/nxënësja mund të sqarojë me fjalët e veta se çka është festa, manifestimi, i emëron festat që festohen në familjen e saj/tij, mund të emëroj së paku një festë të pëkatësive të tjera etnike.

TEMA: VENDI KU JETOJMË

Shembull nr. 10: Vendi im

Qëllimet:

Nxënësi/nxënësja:

- të nxitet ta njoh vendin ku jeton (qytet-fshat),
- të njohtohet me objektet më të rëndësishme në mjedisin më të afërt.

Mjete: fotografi, fotografi nga vendi ku jetoj, pano apo hamer, kasetofon, fletë pune me objektet më të rëndësishme nga rrethi i drejtpërdrejtë, flomasterë

Nocione: fshat, qytet, rrethi i afërt

Vendi ku zhvillohet: klasa, rrethi më i afërt

Rrjedha e aktiviteteve:

AKTIVITETET HYRËSE

Bisedë lidhur me vendin e jetesës, fshat, qytet, vend i vogël, vend më i madh dhe emri i tij. Emri i vendit mund të ndërlidhet me legjendën për emrin ose me informacione të tjera me rëndësi për atë vend.

AKTIVITETET E MËSIMDHËNIES-MËSIMNXËNIES

Vështrim i fotografive nga vendi i jetesës dikur dhe sot dhe përpunim i albumeve të përbashkëta në pano, hamer dhe vend i theksuar në klasë.

Në pano theksohen fotografitë të cilat arsimtari i ka përgatitur prej përpara dhe që i ka marrë prej përpara nga fëmijët, të cilët i kanë sjellë nga shëtitja.

Vizitë e një të rituri dhe tregim i përrallave, ndodhive, legjendave për vendin.

AKTIVITETET EVALUATIVE

Puna në fletën e punës

Cilat objekte më të rëndësishme gjenden në rrethinën tënde. Një nxënësit i jepet fletë pune, duke kërkuar prej tij që t'i rrethojë objektet më të rëndësishme në rrethin e drejtpërdrejtë.

Treguesi i arritjeve:

Nxënësi/nxënësja e din emrin e vendit të vet. I njeh objektet më të rëndësishme të rrethit të drejtpërdrejtë.

TEMA: VENDI KU JETOJMË

Shembull nr. 11: Jeta në të kaluarën

Qëllimet: Nxënësi/nxënësja të njoh ndërtime të vjetra, veshje, mjete,

Mjetet: mjete të vjetra - veshje popullore, gotë (bardak), fener, lugë të drunjta, enë prej balte, kasetë me zakone (shprehi), mbulesë të larme, rrotulluese, fletë pune, hamer ose, pano, fotografi nga ndërtime të vjetra dhe vegla.

Nacionet: veshje, mjete të vjetra, muzej, lojrat në të kaluarën

Vendi i realizimit: klasa

Përgatitja paraprake: vizit në muze, vështrim i shtëpive të vjetra, sende, rroba, përcjellje të kasetës në të cilën janë treguar zakone, shprehi - dasma e Galiçnikut, bisedë me anëtarët e ritur të familjes për jetën në të kaluarën (veshja, mjetet, zakonet), shikim të revistave dhe ilustrimeve me veshje popullore nga krahina të ndryshme.

Rrjedha e aktiviteteve:

AKTIVITETET HYRËSE

Arsimtari bisedon me nxënësit për vizitën në muze vështrim i shtëpive të vjetra, mjete të vjetra , veshje, revista dhe albume.

AKTIVITETET E MËSIMDHËNIES-MËSIMNXËNIES

Para nxënësve vendosen sendet e vjetra (veshja popullore, gotat, luga e drurit, pjata prej balte, feneri) vështrohen me kujdes (madhësia e tyre, forma, ngjyra, era, zërat, zbulohet si janë kur preken - të lëmuara, të ashpra, të ngrohta apo të ftohta). Zhvillohet bisedë për atë se prej çfarë materiali janë të punuara? Për çka shërbejnë? Përse përdoren ato sot? Me çka mund të dallohen nga sendet-veshjet e reja? Pas bisedës sendet mbulohen me mbulesë "Mbulesën magjike". Kërkohet nga nxënësit që të tregojnë se çka fshihet nën mbulesën. Kërkohet që rrëfimi i tyre të arsyetohet, zbulohet dhe kërkohet nga nxënësit të tregojnë për çka ka shërbyer, vallë përdoret edhe sot.

Loja "Rrotulluesja": para nxënësve vendoset "Rrotulluesja", në të cilën janë vizatuar sende nga e kaluara dhe sot, rrotulluesja rrotullohet dhe nga nxënësit kërkohet që ta emërtojnë sendin, të tregojnë vallë është nga e kaluara apo e tashmja dhe të tregojnë se a është përdorur apo përdoret akoma.

AKTIVITETET EVALUATIVE


Nxënësit ndahen në dy grupe dhe çdo grup fiton fotografi nga ndërtime të vjetra dhe fotografi nga vegla dhe veshje të vjetra. 'do grup bën pano të vet dhe e prezenton para nxënësve të tjerë.

Shtojca: fletë pune nr. 3


Treguesit e arritjeve:

Nxënësi/nxënësja emëron vegla të vjetra dhe disa pjesë nga veshjet kombëtare.

Rrotulluesja, shembulli 1



Shembulli 2



TEMA: VENDI KU JETOJMË

Shembull nr. 12: Atdheu im

Qëllimet:

nxënësi/nxënësja ta emëroj atdheun e vetë, t'i njeh flamurin dhe himnin;

- të zhvillojë ndjenjën si pjesë dhe dashurinë ndaj atdheut.

Mjetet: hamer, 9 kartela në të cilat nga njëra anë janë të vizatuara numrat prej 1 deri më 9, ndërsa në anën tjetër janë të shkruara: 1-M, 2-A, 3-Q 4- E, 5-D, 6-O, 7-N, 8-I dhe 9-A, fotografi nga disa qytete të Maqedonisë apo prezantimi, radhitëse – flamurë, fjala *himni*, fotografi nga Shkupi, fotografi me ëmbëlsirë për ditëlindje, kartuça me ngjyrë të kuqe dhe të gjelbër, kasetofon, CD me himnin e Republikës së Maqedonisë.

Nocioni: atdheu.

Vendi i realizimit: klasa.

Rrjedha e aktivitetit

AKTIVITETET HYRËSE

Arsimtari ka përgatitur 19 kartela në të cilat në një rën anë janë të vizatuar numra prej 1 deri 9, ndërsa në anën tjetër janë të shkruar shkronja: 1-M, 2-A, 3-Q 4-E, 5-D, 6-O, 7-N, 8-I dhe 9-A, Ai i ngjet kartelat (nga ana e numrave) të radhitura sipas renditjes së ndryshme dhe i thërret nxënësit që t'i radhisin numrat sipas renditjes dhe të formojnë varg të drejtë numerik. Pas radhitjes së vargut numerik arsimtari i njuh nxënësit se nën secilin numër fshihet një shkronjë. Zbulohet shkronjë pas shkronjë. Pas zbulimit të të gjithë shkronjave, me ndihmën e arsimtarit lexohet fjala e fituar MAQEDONIA. Arsimtari i pyet nxënësit se çka nënkupton fjala ndërsa mandej në hamer i shkruan rrëfimet e nxënësve.

AKTIVITETET E MËSIMDHËNIES-MËSIMNXËNIES

Nxënësit ndahen në tre grupe. Secili grup merr radhitëse – flamuri i Maqedonisë, fjala himn, qyteti Shkupi (apo fotografi nga vendbanimi). Pasi që nxënësit në të tre grupet do t'i rendisin radhitëset, të njëjtat i ngjisin në fjalën MAQEDONIA. Arsimtari bisedon me nxënësit duke parashtruar pyetje: Çfarë forme ka flamuri? Çka ka në flamur? Cilët ngjyra i ka flamuri? Cilët forma 2D shikojnë? Çka nënkupton fjala himn? Si veprohet përderisa dëgjohet himni? Në pyetjen e fundit arsimtari thekson se kur dëgjohet himni çdoherë qëndrohet qetë. Ju tregohet videoinçizim nga fillimi i ndonjë gare sportive kur luan reprezentacioni i Republikës së Maqedonisë dhe kur intonohet himni maqedonas.

Theksohen fotografi apo përgatitet prezantim „Shëtitje në mëmëdheun tim”, përmes së cilës nxënësit njihen me disa qytete në Maqedoni si psh: Shkup, Manastir, Prilep, Ohër, Strugë, Kumanovë dhe Tetovë.

Arsimtari tregon fotografi të ëmbëlsirës dhe i pyet nxënësit se si është ëmbëlsira (e ditëlindjes), si dhe me ç'rast përgatitet ajo. Ai i njofton nxënësit se dhe Maqedonia ka ditëlindjen e sajë dhe festohet më 8 Shtator (rikujtimi i nxënësve për festën e 8 Shtatorit).

AKTIVITETET EVALUATIVE

Mandej nxënësit përgatiten për lojën „Kuis” (vlerësimi se sa nxënësit e kanë përvetësuar materialin). Veçohen semaforë me ngjyrë të kuqe që nënkupton „jo” dhe me ngjyrë të gjelbër që nënkupton „po”. Arsimtari u lexon nxënësve tregime të ndryshe ndërsa ata i ngitin kartonat sipas mendimeve të tyre (për „po”ngritin karton me ngjyrë të gjelbërt ndërsa „jo”karton me ngjyrë të kuqe).

Temat:

1. Atdheu im quhet Maqedonia. (PO apo JO)
2. Shkup, Ohër dhe Tetovë janë qytete në atdheun tim Maqedoni. (Po ose Jo)
3. Flamuri i Maqedonisë ka ngjyrë të gjelbër
4. Përderisa e dëgjojmë himnin duhet të vrapojmë. (PO apo JO)
5. Në flamur ka të vizatuar diell.. (PO apo JO)
6. Qyteti më i madh në Maqedoni është Shkupi. (PO apo JO)

Treguesit e të arriturave

Nxënësi/nxënësja mund me fjalët e veta ta sqarojë nocionin mëmëdheu, i njeh flamurin maqedonas dhe himnin e Maqedonisë.

TEMA: KOMUNIKACIONI

Shembull nr. 13: Ecje e sigurtë dhe kalimi i rrugës

Qëllimet: Nxënësi/nxënësja i njohin rregullat e ecjes së sigurtë nëpër trotoar, kalimin e rrugës,

Mjetet: tregim sipas serisë së fotografive (4 fotografi për rrugën e fëmijës nga shtëpia deri në shkollë), pajisje për vizatim, kasetofon, CD

Nocionet: këmbësorë, automjete, trotoar, kalim këmbësorësh

Vendi i realizimit: klasa, mjedisi i drejtpërdrejtë

Rrjedha e aktiviteteve:

AKTIVITETET HYRËSE

Shëtitje në rrethin e afërt dhe vështrim i komunikacionit në rrugë. Bisedë për mjetet e komunikacionit që i shikojnë, për njerëzit ku lëvizin, varësisht nga mjedisi dhe vendi i vështrimit.

AKTIVITETET E MËSIMDHËNIES-MËSIMNXËNIES

Pas kthimit në klasë arsimtari e vazhdon bisedën me nxënësit për atë që është vërejtur. Ai ju tregon katër fotografi nxënësve (ecje e mirë dhe ecje e paprshtashme e këmbësorëve në tretoar dhe kalim i drejtë dhe i gabueshëm i rrugës).

Zhvillohet bisedë me nxënësit sipas fotografive, (Pse fëmijët i mbajnë prindërit për dore ku ecin nëpër trotuar dhe e kalojnë rrugën? Pse ekziston kalimi për këmbësorë? Çka do të ndodh nëse nuk ecim nëpër trotuar? Çka mund të ndodh nëse vrapojmë nëpër trotuar ? etj).

AKTIVITETET EVALUATIVE

Organizohen lojra në qilimin e komunikacionit ose në oborin e shkollës nxënësit ushtrojnë kalimin e rrugës dhe ecje nëpër trotuar.

Treguesit e arritjeve:

Nxënësi/nxënësja njih e rrugë, kalimit për këmbësorë, trotuar, tregon si drejt kalohet rruga i shoqëruar nga të rriturit

TEMA: KOMUNIKACIONI

Shembull nr. 14: Para semaforit

Qëllimet: Nxënësi/nxënësja të njihet me rolin e sinjalizimit ndriçues të semaforit.

Mjetet: maketë komunikacioni, lojërë-semafor, material hedhës, ngjitëse, gërshërë

Nocione: semafor, dritë e kuqe, e verdhë, e gjelbër

Vendi i realizimit: klasa

Rrjedha e aktiviteteve:

AKTIVITETET HYRËSE

Në klasë vendoset maketa e komunikacionit apo e njejtja bëhet me letër ngjitës dhe zhvillohet bisedë me nxënësi për atë se çka ka në maketën e komunikacionit.

AKTIVITETET E MËSIMDHËNIES-MËSIMNXËNIES

Para nxënësve arsimtari realizon pjesë teatrale “Semafori dhe kukulla Maja...”

Pasi të ndiqet shfaqja zhvillohet bisedë lidhur me përmbajtjen e saj (Ku janë njohur semafori dhe kukulla Maja? Përse rruga është e rrezikshme për të luajtur? Çka tregojnë shenjat e semaforit? Çka do të kishte ndodhur nëse kukulla Maja nuk do të vepronte sipas semaforit?)

Në klasë ose në oborin e shkollës improvizohet komunikacioni ku vendosen semaforë dhe ushtrohet kalimi i drejtë në rrugë.

AKTIVITETET EVALUATIVE

Luhet loja “Semafori” – nxënësit janë ndarë në tre grupe. Çdo grup merr rreth me ngjyrë, i cili i shënon dritat e semaforit. Arsimtari në dorë mban flamuj me ngjyrë të kuqe, të verdhë dhe të gjelbër.

Kur arsimtari do ta ngrëjë flamurin e kuq, nxënësit me rrethet e kuqe duhet të ngrihen, mandej kur arsimtari e ngrë flamurin e gjelbër ngrihen nxënësit me rrethin e gjelbër, kurse e njëjta vazhdon edhe me rrethin e verdhë. Loja vazhdon derisa ka interes për të.

“Semafori dhe kukulla Maja” – dramatizim nga ana e nxënësve

Treguesit e arritjeve:

Nxënësi/nxënësja e njohin sinjalizimin ndriçues të semaforit dhe rëndësinë e tij.

Teksti shtojcë – Semafori dhe kukulla Maja

Semafori dhe kukulla Maja (lojra me kukulla)

(Është një udhëkryq dhe në të qëndron semafori serioz. Rreth semaforit rrotullohet kukulla kurioze Maja)

SEMAFORI: Cila je ti bukuroshe që gjith ditën rrotullohesh si rrotulluese?

KUKULLA: Urdhëro?

SEMAFORI: Nuk ja miku yt nga parku zbavitës. Më dëgjon?

KUKULLA: Eee, po bëhesh i rëndësishëm

SEMAFORI: Unë? (qeshet) moti nuk kam qeshur. Nga doli kjo kështu, që unë po u bëkam i rëndësishëm. E nuk njihemi, kukull!

KUKULLA: Pikërisht këtë dua ta them:si mund të jesh i vetmi që nuk e njeh princeshën Maja!?

SEMAFORI: domethën ti je princeshë...!Ja, pashë edhe princeshë!...Më vjen keq që nuk jemi takuar në ndonjë vend tjetër!

KUKULLA: Përndryshe ti po më dukesh mjaft interesant! Si quhesh?

SEMAFORI: Quhem Semafor Triokovski.

KUKULLA: Çfarë emër i çuditshëm, por i vështirë për t’u mbajtur mend.

SEMAFORI: Sa e di unë princeshat janë pak më të mëdhaja se ti!?

KUKULLA: Unë jam kukulla më simpatike e Milkës prandaj jam e lazduar.

SEMAFORI: Këtë e vërejtta qysh se erdhe të luash në vendin më të rrezikshëm të qytetit!

KUKULLA: Nuk din të luash?

SEMAFORI: Di, kukullo, por tani duhet të jem serioz!

KUKULLA: Më gënjen?

SEMAFORI: Unë nuk di të gënjej, pasha sytë e mi! Ashtu e kam shërbimin!

KUKULLA: Atëherë, Semafor, përse nuk bën me shenjë? Një herë me të kuqen, një herë me të verdhën, një herë me të gjelbrën?

SEMAFORI: Unë nuk të bëj me shenjë por të parandaloj dhe të them se çka duhet të bësh kur të gjendesh në këtë vend të rrezikshëm.

KUKULLA: Ti luan policin e komunikacionit?

SEMAFORI: Unë e zëvendësoj atë, ose ai mua. Tani e ke të qartë?

KUKULLA: Eh, polici i komunikacionit din të fërshëllejë, kurse ti nuk din as të ecësh?!

SEMAFORI: **(me zë më të lartë)** Të lutem mos më ofendo kur jam në detyrë!

KUKULLA: E çka të bëj, hajde tregomë pasi ti je më i mençur?

SEMAFORI: Të shkosh në shtëpi, ta përshëndesësh Milkën e cila aq shumë të ka lazduar e unë mandej të vazhdoj punën në udhëkryq!

KUKULLA: Sa interesante është kjo! (Flladitet me flladitëse)

SEMAFORI: Por, atëherë ti e para do të biesh viktimë, kukullo. Do të përfundosh keq, sepse, po shihet që nuk bën dallim në mes foshnjores (kopshtit) dhe udhëkryqit. E atëherë mua do të më dënojnë, domethënë do të më largojnë nga puna!

KUKULLA: Uuu, kjo është e dhimbshme! Tregomë si ta kaloj rugën?

SEMAFORI: (Pasi të dëgjohet zhurmë e fortë) E, prandaj jam unë këtu që të të tregoj kur ta kalosh rrugën. E shikon syrin tim të kuq?

KUKULLA: Po e shikoj.

SEMAFORI: Qëndro edhe pak. Tani do të ndriçojë e verdha.

KUKULLA: Po shikoj. Ja, ndriçon e verdha.

SEMAFORI: Përgatitu (e mbyll syrin e verdhë)

KUKULLA: Të kaloj?

SEMAFORI: Prit! Prite të gjelbrën! (ndriçon ngjyra e gjelbër) Tani mund të kalosh përmes zebrës, sepse i ndalova automobilat.

KUKULLA: **(Duke kaluar)** Uuu ky vërtet e paska! Të gjithë e dëgjojnë dhe e respektojnë, madje edhe kamionat!... E, unë nuk kam lindur që të respektoj dikë, por

mua të më respektojnë. Menjëherë do të shkoj në shtëpinë e mallrave t'i shoh shoqet e mia të ekspozuara.

SEMAFORI: **(Me zë, nga larg)** Më fal princeshë! Hajde sërish kur jam i lirë!

KUKULLA: Nuk dua të marthohem me ty. Ti nuk di të luash. Por aq mirë bën me sy!...

Më vjen keq shumë!

(shkon dhe këndon)

“Skena e lumtur” – Risto Davçevski

TEMA: KOMUNIKACIONI

Shembulli nr.15 Mjetet e komunikacioni

Qëllimet: nxënësi/nxënësja t'i din t'i përshkruaj mjetet e komunikacionit të cilat më shpesh i has.

Mjetet mësimore: hamer, aplikacione të mjeteve të komunikacionit (aeroplan, anije, automobil, biçikletë, tren, autobus) ngjitës, strajcë, videoprezantim, lodra „mjete të komunikacionit”.

Nocione: mjetet e komunikacionit, makina, autobusi, treni, anija, aeroplani, biçikleta.

Vendi i realizimit: klasa.

Aktiviteti paraprak: shëtitje në komunikacionin më të afërt dhe vëzhgimi i mjeteve të komunikacionit.






Rrjedha e aktivitetit

AKTIVITETET HYRËSE

Në fillim të orës luhet loja „Anijet në mjegull”. Njërit nxënës i lidhen sytë me shami dhe ai me ndihmën e udhëzimeve të „drejtuesin” do të duhet të kalojë rrugë në të cilën ka pengesa, deri te caku.

AKTIVITETET E MËSIMDHËNIES-MËSIMNXËNIES

Nxënësit janë të ulur në tepihë në rreth dhe me numëratore përcaktohen gjashtë nxënës të cilët nga strajca nxjerrin aplikacione të mjeteve të komunikacionit (aeroplan, anije, automjet, biçikletë, tren, autobus), i emërojnë, tregojnë se vallë i kanë parë në shëtitjen paraprake apo në vend tjetër. Secili aplikacion ngjitet në hamerin e përgatitur paraprakisht.



Arsimtari e tregon videoprezantimin e përgatitur me mjetet e theksuara paraprakisht të komunikacionit, i përshkruan dhe sqaron si dhe se si lëvizin dhe çka transportojnë (udhëtarë, gjësende...).

Mandej arsimtari i ndan nxënësit në gjashtë grupe të cilët marrin detyrë të marrin nga dy lodra „ mjete të komunikacionit” dhe në nivel të grupit t'i përshkruajnë dhe të vërejnë ngjashmëri dhe dallime ndërmjet tyre. Grupi i parë duhet të përshkruaj aeroplan dhe autobus, grupi i dytë tren dhe anije, grupi i tretë makinë dhe biçikletë. Grupet tjera (grupi i katërt, i pestë dhe i gjashtë) i kanë detyrat e njëjta si e para, e dyta dhe e treta.

Në fund nxënësit e secilit grup prezantojnë se çka kanë punuar, përderisa tjerët i përcjellin me vëmendje. Arsimtari i incizon rrëfimet e nxënësve.

AKTIVITETET EVALUATIVE

Emërim i drejtë i mjeteve të komunikacionit pas tërheqjes së aplikacioneve, si dhe analiza e përshkrimeve dhe dallimet e vërejtura ndërmjet mjeteve të komunikacionit të shprehur nga nxënësit.


Treguesit e të arriturave

Nxënësi/nxënësja i emëron dhe mund t'i përshkruaj mjetet e komunikacionit të cilët më shpesh i has.


FLETË PUNE NR.1



FLETË PUNE NR. 2



FLETË PUNE NR. 3



IV. SHEMBUJ TË AKTIVITETEVE SIPAS TEMAVE MËSIMORE PËR KLASËN E II

Në programin për klasën e II përfshihen këto tema: **Unë dhe të tjerët; Jeta dhe puna në shkollë; Vendi im; Shtëpia ime dhe Komunikacioni.**

TEMA: UNË ME TË TJERËT

Shembulli 1: Çka më pëlqen në vetvete?

Qëllimet: nxënësi/nxënësja të dijë të prezentohet, të tregojë çka dijn çka dëshiron.

Mjetet mësimore: fletëza me emra të shkruar të fëmijëve, mjete për vizatim.

Nocionet kryesore: mundem, dua

Vendi i realizimit: klasa

Rrjedha e aktivitetit

AKTIVITETET HYRËSE

Nxënësit ulen në rreth. Mësuesja e fillon lojën „Më pëlqen emri im”. Secili nxënës tregon pse i pëlqen emri, se si e ka marrë, në çka e kujton ose cili personalitet i njohur e ka këtë emër, se si duan ta thërrasin në mënyrë përgëdhelëse etj.

AKTIVITETET E MËSIMDHËNIES - MËSIMNXËNIES

Inicohet loja: „Çka më pëlqen në vetëvete” (Në fletushka janë shënuar të gjithë emrat e fëmijëve. Letrat e thyera vëndosen në kuti dhe përzihen. Ndonjë prej fëmijëve tërheq letrën, kurse fëmiju emri i të cilit është në letër duhet të tregojë se çka i pëlqen tek ai dhe sa çka mundet (dhe nëse dëshiron nxënësi mundet të këndojë, të recitojë, të vallëzoj, të aktroj, të vizatojë ose diçka tjetër që në veçanti dëshiron).

Loja tjetër është „Fjalë të bukura” (Nxënësit janë të rradhitur në dy rreshta me fytyrë të kthyer ndaj tjetrit. Njëri rresht është statik, kurse nxënësit nga rreshti tjetër vëndosen çdoherë për një vend djathtas, një nga një. Për secilën vëndosje vijuese mësuesi jep shenjë (me dorë). Nxënësit të cilët vëndosen pranë çdonjërit nxënës tjetër nga rreshti statik duhet ti thuan fjalë të bukura për atë. Loja mbaron kur secili nxënës do të kthehet në gjendjen e mërrparshme.

Vijon bisedë për atë se si ndjehen kur dëgjojnë fjalë të bukura për vetëveten edhe për të tjerët. Vallë kjo i bën të lumtur?

AKTIVITETET EVALUATIVE

Nxënësit marrin detyrë që të vizatojnë në fletë se çka u pëlqen në vetëvete edhe atë ta tregojnë para tjerëve në paralele.

Treguesit për të arriturat

Nxënësi/nxënësja mund të përshkruajë se me çka krenohet sa i përket njohurive, shkathtësive dhe aftësive të veta.

TEMA: UNË METË TJERËT

Shembulli nr.2: Rregullat në paralele, shkollë

Qëllimet: nxënësi/nxënësja të marrin pjesë në sjelljen e rregullave të sjelljes në klasë

Mjetet: hamer dhe markerë.

Nocionet: rregullat dhe respektimi i rregullave.

Vendi i realizimit: klasë.

Rrjedha e aktivitetit

AKTIVITETET HYRËSE

Lojë: Nxënësit radhiten në rreth. Arsimtari ju jep detyrë të mendojmë se në cilin drejtim do të dëshirojnë të lëvizin. Me shenjën e tij „fillo” ata duhet të lëvizin nëpër hapësirën/klasën në drejtim të cilin e kanë menduar. Loja përsëritet në disa kthesa me shenjën e arsimtarit „fillo” dhe „ndal”.

Vijon **diskutimi**. Vallë mundet të lëvizni në drejtim të dëshiruar, ballafaqoheni me vështirësi dhe pengesa dhe si i tejkaloni?

Përfundimi: Nxënësit hasin vështirësi për shkak se nuk kanë marrë udhëzime se në cilin drejtim do të lëvizin, nuk kishte rregull sipas së cilës ata do të kishin lëvizur dhe për atë ndodhin përleshje ndërmjet nxënësve. Si mund të tejkalohet kjo? Përfundimi do të ishte: me vendosjen e rregullave.

AKTIVITETET E MËSIMDHËNIES DHE MËSIMDHËNIES

Arsimtari e fillon aktivitetin me fjalët: Ashtu si ka rregulla secila lojë ka rregulla për lojë, ashtu edhe secila bashkësi duhet të ketë rregulla të veta të sjelljes që të

mund të funksionojë mirë. Meqë edhe ne jemi një bashkësi dhe pjesën e madhe të kohës e kalojmë bashkërisht në klasë dhe në shkollë, duhet bashkërisht të merremi vesh për rregullat e sjelljes.

Çka mendoni çfarë rregulla të sjelljes duhet të ketë në klasë që të mund:

- Më mirë të punojmë së bashku;
- Të ndjehemi mirë;
- Të dëgjohemi njëri me tjetri;
- Të respektohem mes veti;
- Në shkollë të vijmë me kohë;
- Të ndjehemi të sigurt në korridoret e shkollës;
- Të mos ofendojmë me fjalë dhe mos përqeshemi kur dikush thotë diçka, madje edhe nëse diçka është gabim?

Në çdo përgjigje të nxënësit, arsimtari e parashtron pyetjen *Pse?* Me qëllim që të shihet funksioni i rregullës. Nga biseda realizohen rregullat, shkruhen/vizatohen në mënyrë simbolike në hamer të madh i cili më pas do të prezantohet në klasë dhe do të rikujton në rregullat e caktuara.

Rregullat duhet të jenë të shkurtra dhe të qarta. Psh.fjala merret duke e ngritur dorë, kur dikush flet ne të tjerët dëgjojmë...

Shumë është me rëndësi kur të realizohen rregullat të nxitet çdo fëmijë, të merr pjesë, para se të shkruhet rregulla, të dëgjohen argumentet për dhe kundër rregullës, ndërsa të theksohen argumentet në dobi të rregullës.

Nxënësit duhet të pajtohen me rregullat para se ajo të shkruhet në hamer. Rregullat e caktuara duhet të respektohen njejtë si nga mësimdhënësi ashtu edhe nga nxënësit.

AKTIVITETET EVALUATIVE

Mësimdhënësi zhvillon diskutim për atë se cili është caktuar për respektimin e rregullës, kush do të kujdeset për këtë që secili t'i respektojë rregullat, çka do të ndodhë kur dikush nuk i respekton rregullat e caktuara. Nga përgjigjet e nxënësve caktohen dhe shkruhen procedurat të cilat do të realizohen në qoftë se dikush nuk i respekton rregullat.

Treguesit e të arriturave

Nxënësi/nxënësja në mënyrë aktive merr pjesë në caktimin e rregullave dhe mund t'i numërojë dhe sqarojë rregullat e caktuara të sjelljes në paralele dhe në shkollë

TEMA: UNË ME TË TJERËT

Shembulli nr. 3: Të drejtat dhe përgjegjësitë

Qëllimet: nxënësi/nxënësja të dijë se secili ka të drejtat dhe përgjegjësitë.

Mjetet: rrugë e improvizuar me shenja komunikacioni, kalim për këmbësorë, trotuar, fotografi për këmbësorë dhe fotografi për mjete të ndryshme të komunikacionit (automjete, maune, motorë, biçikleta) të cilat nxënësit i mbajnë të ngjitur, mbishkrim në të cilin në veçanti janë shkruar të drejtat e fëmijëve dhe veglat për vizatim.

Nacionet: të drejtat, përgjegjësitë.

Vendi i realizimit: klasë.

Rrjedha e aktiviteteve

AKTIVITETET HYRËSE

Loja: „Të drejtat, të drejtat”. Në rrugën e improvizuar lëvizin automjetet dhe këmbësorët. Mësimdhënësi është në rolin e policit i trafikut i cili rregullon komunikacionin dhe tregon për gabimet. Kur mësimdhënësi të thotë: „Më nuk ka të drejta”, jep instruksione se më nuk ka polic trafikut dhe secili mund të lëvizë ku të dëshirojë pa i respektuar rregullat. Kur të thotë: „Rregulla, rregulla” përsëri respektohen rregullat. Pasi të ndërpritet aktiviteti fillon biseda. Loja mund të përsëritet 3-4 herë me një grup të ndryshëm të nxënësve.

AKTIVITETET E MËSIMNXËNIES-MËSIMDHËNIES

Mësimdhënësi fillon diskutimin: SI ishte përderisa u respektuan rregullat? Çka ndodhi kur nuk u respektuan rregullat? Kush ndodhet në rrezik në rrugë? Pse janë të nevojshme rregullat në komunikacion? Çka mendoni, vallë rregullat në komunikacion (ndalesat) na i humbin të drejtat? Për shembull: Mos rri gjatë në kalimin e këmbësorëve; Mos vrapo në rrugë kur është e ndezur drita e kuqe etj.

Lexohen dhe analizohen të drejtat të shkruara në poster. Fëmijët kanë të drejtat e tyre: Secili fëmijë ka të drejtë për jetë të lumtur familjare, kujdesin dhe dashurinë e prindërve; Fëmijët kanë të drejtë të shoqërohen dhe të bashkëpunojnë.

Pastaj bisedohet për atë se nga të drejtat dalin dhe përgjegjësitë (përgjegjësitë ndaj familjes, premtimet, puna, rregullat dhe ligjet).

Punëtorja:Nxënësit punojnë në grupe për shkarkimin e situatës së caktuar. Mësimdhënësi gojarisht i parashtron pyetjet, ndërsa përgjegjësi i grupit ka të drejtë të konsultohet me anëtarët e grupit të vet, e më pas ta jep përgjigjen.

Ka formuar katër grupe dhe secili grup merr përshkrimin e situatës në veçanti.

Grupi i parë: Marija çdo herë e përfundon detyrën e shtëpisë para se të shikojë televizion.

Grupi i dytë:Elena i premtoi mësimdhënëses se nuk do të flet në orë.

Grupi i tretë: Borjani patjetër duhet të jetë në treningun e basketbollit në orën 8.

Grupi i katërt: Angela së pari do të shikojë të dyja anët e rrugës dhe pastaj do ta kalojë atë.

Për secilën situatë parashtrihen pyetjen vijues:

Kush ka përgjegjësi?

Çfarë përgjegjësie ka?

Kush ia ka dhënë atë përgjegjësi?

Çka do të ndodhë nëse personi nuk është i përgjegjshëm?


AKTIVITETET EVALUATIVE

Secili nxënës merr për detyrë në gjysmën e letrës të vizatojë situatë në të cilën do ti paraqesë të drejtën që dëshiron ta ketë, ndërsa në gjysmën tjetër të letrës ta vizatojë përgjegjësinë çka del nga ajo e drejtë.

Treguesit e të arriturave:

Nxënësi/nxënësja ka vizatuar situatë për të drejtën që dëshiron ta ketë dhe përgjegjësinë e cila del nga ajo e drejtë.

Shtojca 1



TEMA: JETA DHE PUNA NË SHKOLLË

Shembull nr.4: Bëj lodër

Qëllimet: nxënësi/nxënësjja ta kuptojë rëndësinë e fjalës e *drejtë*.

Mjetet: fleta të mëdha prej letre, lapsa, guma, fllomasterë, fleta me ngjyra të ndryshme, gërshtë, ngjitës, letër kartuçi me ngjyra të ndryshme, vizore, penj, materiale prej plastike

Nocionet: drejtësia.

Vendi i realizimit: klasa

Rrjedha e aktivitetit

AKTIVITETET HYRËSE

Nxënësit ndahen në gjashtë grupe. Detyra e tyre është që të bëjnë lodra më të mira që mundën me ndihmën e materialeve që iu jepen.

Grupet marrin material sipas kësaj radhitje:

Grupi 1 dhe 2 – letër të madhe dhe katër lapsa;

Grupi 3 dhe 4- letër të madhe, katër lapsa, dy goma dhe një komplet flomasterë;

Grupi 5- letër të madhe, katër lapsa, dy goma, një komplet flomasterësh, katër fleta me ngjyra të ndryshme, dy palë gërshërë dhe ngjitës.

Grupi 6 – fletë e madhe, katër lapsa, dy goma, një komplet flomasterësh, katër fleta me ngjyra të ndryshme, dy palë gërshërë dhe ngjitës, katër copa letre kartuçi me ngjyra të ndryshme, vizore, penj, materiale prej plastike.

Materialet për nxënësit do të varem nga ajo se çka ofron arsimtari.

Ajo që është e rëndësishme të theksohet te kenë kujdes që shpërndarja e materialeve të mos jetë e barabartë apo e njëjtë, përkatësisht njëri grup të jetë i favorizuar sa i përket grupit tjetër. Nëse ka numër më të madh të nxënësve mund të bëhen edhe më tepër grupe , me çka ata do të marrin material të njëjtë, ashtu si grupet 3 dhe 4.

AKTIVITETET E MËSIMDHËNIES-MËSIMNXËNIES

Pas shpërndarjes së materialeve, nxënësit punojnë në grupet e veta nga 10-15 minuta. Mandej arsimtari iu tregon se kanë edhe 10 minuta për ta përfunduar detyrën dhe se do të vijojë gara që të përzgjidhet loja më e mirë. Në qoftë se nxënësit fillojnë të reagojnë në shpërndarjen jo të drejtë të materialeve duhet t’iu tregohet për këtë të bisedojnë pasi që të përfundojnë me detyrat dhe se duhet të jenë kureshtarë që ta bëjnë lojën sa më mirë me materialet që i disponojnë. Pasi të përfundojnë me punën një anëtar i secilit grup do ta prezantojë lojën që e kanë realizuar.

AKTIVITZETET EVALUATIVE

Arsimtari e zhvillon diskutimin rreth së drejtës me ndihmën e këtyre pyetjeve:

- Si ndjeheni pasi vërejtët se secili grup ka material të ndryshëm?
- Si janë ndje nxënësit të cilët ishin në grupin i cili ka marrë më tepër materiale? Si do të ndjeheni në qoftë se do të ishit në ndonjë grup tjetër ?
- Si janë ndje nxënësit të cilët kanë qenë në atë grup me më pak materiale?
- Vallë ndonjë prej grupeve ka tentuar të bëjë diçka që ta rregullojë pabarazinë (padrejtësinë)? Nëse po vallë ajo është efektive?
- Si do të dukej ndarja korrekte e materialeve në grupe?
- Vallë është korrekte të mbahet garë kur nxënësit marrin materiale jo të njëjta për punë?

Treguesit e të arriturave

Nxënësi/nxënësja mund me fjalë të veta ta sqarojë nocionin drejtësi dhe të përmend shembuj të pasojave nga padrejtësia.

TEMA: VENDI IM

Shembulli numër 5: Maqedonia – Atdheu im

Qëllimet: nxënësi/nxënësja të njihet me karakteristikat e ndryshme natyrore të atdheut të tij/saj.

- të zhvillohet ndjenja e përkatësisë ndaj atdheut të tij/saj.

Mjetet: kartolina, fotografi, prospekte nga Maqedonia, film të shkurtë apo fotografi me bukuritë e mëmëdheut, tekst për Republikën e Maqedonisë, fleta pune.

Nocionet: mëmëdheu

Përgatitja paraprake: nxënësit të sjellin kartolina dhe fotografi me vende dhe bukuritë natyrore të atdheut tonë.

Vendi i realizimit: klasë

AKTIVITETET HYRËSE

Arsimtari paraqet një film të shkurtër apo fotografi për bukuritë natyrore dhe karakteristikat e atdheut. Ai bisedon me nxënësit për bukuritë e atdheut tonë Republikën e Maqedonisë dhe madje shikojnë prospekte dhe kartolina. Bisedë për nxënësit për atë se si quhet atdheu ynë, çka nënkupton fjala „atdhe”ku janë të lindur, sa familjarë dhe miq kanë këtu.

AKTIVITETET E MËSIMNXËNIES - MËSIMDHËNIES

Arsimtari lexon tekst për bukuritë natyrore dhe karakteristikat e atdheut (mund të jetë i shkruar edhe nga ndonjë nxënës). Bisedë me nxënësit për atë se i kujt është mëmëdheu, për bukuritë e atdheut dhe për atë se çka do të kishit bërë për atdheun tuaj. Si psh. Teodora dashurinë ndaj atdheut e ka shprehur në këtë përbërje:

Atdheu im quhet Republika e Maqedonisë. Ai është i vogël, por aty ka vend për të gjithë që e duan. Atdheu është shtëpia ime e preferuar. Këtu u linda, babai im, nëna dhe gjyshi im janë lindur këtu.

Shumë është bukur. Aty ka fusha të gjelbëra dhe male të larta. Atë e zbukurojnë përrenj dhe lumenj të mëdhenj. Gjithashtu ka liqene shumë të bukura natyrore dhe plazhe me rërë.

AKTIVITETET EVALUATIVE

Arsimtari ju ndan fleta pune me pyetje që kanë të bëjnë me atë se vallë dinë se si quhet atdheu i tyre, cili është flamuri, stema, të tregojnë disa karakteristika që i kanë apo i kanë vizituar. Arsimtari mund t'ju tregojë panorama, fotografi dhe nxënësit të tregojnë se për çka punohet (flamuri, stema, Liqeni i Ohrit, përmendorja e Goce Dellçevit etj).

Treguesit e të arriturave

Nxënësi/nxënësja mund të numëron dhe përshkruan disa bukuri natyrore të atdheut të tij Republikën e Maqedonisë dhe me fjalët e veta ta shpreh dashurinë ndaj atdheut.

TEMA: VENDI IM

Shembulli numër 6: Ndërtimet e vjetra në vendin tim

Qëllimet: nxënësi/nxënësja të njeh dhe krahasojë ndërtimet e reja dhe ato të vjetra.

Mjetet: ilustrime dhe fotografi të objektit (psh.: ndërtim i vjetër ora e qytetit, shtëpia e vjetër, shtëpia e re etj.), fletë pune, ngjyra druri, kasetofon dhe bisedë e inçizuar, legjendë (këngë popullore burimore).

Nacionet: trashëgimia kulturore.

Vendi i realizimit: klasë.

Përgatitja paraprake: organizimi i vizitave në objekt dhe bisedim me kustosin dhe persona tjerë (banorë të vjetër të vendit, gjyshja e ndonjë nxënësi/nxënëse, arkitekt, prindi i ndonjë nxënësi/nxënëse dhe ngjashëm).

Rrjedha e aktiviteteve

AKTIVITETET HYRËSE

Arsimtari iu lexon nxënësve legjendën (këngë, tregim) që ka të bëjë me ndërtimin e vjetër ose, poashtu iu lëshon këngë popullore burimore. Ai zhvillon bisedën me nxënësit në lidhje me ndërtimeve të vizituara (ose për atë që theksohet në këngë ose tregim). I shikojnë ilustrimet, fotografitë dhe dëgjojnë pjesë të zgjedhura nga biseda e inçizuar.

AKTIVITETET E MËSIMDHËNIES – MËSIMNXËNIES

Arsimtari i ndanë nxënësit në katër grupe . Secili/a nxënës/nxënëse merr fletë pune me detyrë të vizatojë ndërtimet e vjetra dhe ndërtimet e reja që kanë vizituar. Pastaj nxënësit në kuadër të grupit të vet bisedojnë për ngjashmëritë dhe dallimet ndërmjet ndërtimeve të vjetra dhe të reja (brenda dhe jashtë) dhe atë e shkruajnë.

AKTIVITETET EVALUTIVE

Prezantimi i së punuarës (dy përfaqësues të secilit grup) para nxënësve tjerë.

Treguesit e të arriturave

Nxënësi/nxënësja mund të përshkruajë më së paku një ndërtim të vjetër dhe të numërojë disa dallime ndërmjet ndërtimeve të vjetra dhe të reja.

TEMA: VENDI IM

Shembulli 7: Vendi ku jetojë

Qëllimet: nxënësi/nxënësja t'i zgjerojnë njohuritë për karakteristikat më të rëndësishme në vendin ku jetojnë (qytet, fshat, lagje).

Nacionet kyçe: qytet, fshat, lagje

Mjetet: kamerë, fotografi me pasqyrën e shkollës, spitali, posta, pemëtaria, shitorja.

Vendi i realizimit: klasa.

Rrjedha e aktivitetit

AKTIVITETET HYRËSE

Loja: Asociime. Nxënësit marrin detyrë që të mendojnë dhe të përgjigjen në pyetjen: Në çka mendoni kur do të përmendet fjala fshat? Arsimtari në tabelë i shënon rrëfimet e veta. Mandej parashtrohet pyetje: Në çka u associon kur përmendet fjala qytet? Çka mendoni kur do të përmendet fjala lagje. Arsimtari edhe këto tregime i shënon në tabelë. Zhvillon bisedë për ngjashmëritë dhe dallimet

AKTIVITETET E MËSIMNXËNIES - MËSIMDHËNIES

Punëtorja: Me numërimin prej 1 deri 3 apo prej 1 deri më 6 varësisht prej numrit të nxënësve në paralele formohen tre deri në gjashtë grupe. Secili prej grupeve merr fotografi me ilustrime në të cilët janë paraqitur (shtëpi, ndërtesa, kafshë shtëpiake, parqe, kopshte pemësh etj). Nxënësit në kuadër të grupit duhet t'i shikojnë fotografitë dhe t'i ndajnë ata me ndihmën në të cilën më së miri do të paraqiten karakteristikat e një lagje (grupi 1 dhe 4), fshat (grupi 2 dhe 5) dhe qyteti (grupi 3 dhe 6). Fotografitë i ngjisin në pllakat të përbashkët dhe punën e tyre e prezantojnë para nxënësve.



AKTIVITETET EVALUATIVE

Secili anëtarë i grupit përpunimin e vetë e inkorporon në hartë të përbashkët (skemë konceptuale) e qytetit me lagje dhe fshatra..

Treguesit e të arriturave

Pllakat të përpunuara me pasqyrën e qytetit, fshatit dhe lagjes të vendosur në mënyrë adekuate në hartën e përbashkët.

TEMA: SHTËPIA IME

Shembulli numër 8: Hapësira në shtëpi

Qëllimet: nxënësi/nxënësja ta dijë funksionin e hapësirave në shtëpi dhe të emërtojë pjesë të mobilieve.

Mjetet: fotografi me pjesë të mobilieve në shtëpi, fletë bloku, ngjitës, laps, fletë pune.

Nocionet: hapësirat në shtëpi, mobiliet.

Vendi i realizimit : klasë

Rrjedha e aktiviteteve

AKTIVITETET HYRËSE

Nxënësit e rregullojnë këndin familjar në klasë, mandej e luajnë lojën Vendos mobiliet! Nxënësit janë të ndarë në dy grupe. Në tavolinë ka të përzier një numër të barabartë të ilustrimeve me mobilie të ndryshme të shtëpisë dhe pesë kutia në të cilat janë të shkruara emrat e hapësirave në shtëpi (dhoma e ditës, kuzhina, trapezaria, dhoma e fëmijëve). Pasi të ftojë arsimtari nga një nxënës/nxënëse del, e merr ilustrimin dhe e vendos në kutinë përkatëse.

Fitues është ai grup që saktë dhe shpejtë do ta përzgjedhë mobiljen në shtëpi .

AKTIVITETET E MËSIMDHËNIES-MËSIMNXËNIES

Nxënësit ulen në pesë grupe, ndërsa para tyre ka të vendosur nga një prej kutive me ilustrime të mobiljeve të përzgjidhura sipas hapësirave. Nxënësi i cili me kërkesë të mësimitdhënësit merr ilustrim nga kutia duhet ta emërtojë mobiljen që

është vizatuar në ilustrim. Gjithashtu, nxënësi jep përgjigje pyetjeve nga mësimdhënësi për çka nevojitet mobilja, prej çka është e ndërtuar dhe si duket. Mësimdhënësi iu thot nxënësve ta vizatojnë këndin e tyre për fëmijë, mandej të bisedojnë në pyetjet vijuese:

1. Kush kujdeset për atë se si është rregulluar shtëpia (me çfarë mobiljesh), vallë nxënësit kanë marrë pjesë në pajisjen e shtëpisë (të tregojnë nga një shembull)?
2. Kush kujdeset për higjienën në shtëpi?
3. Vallë ka rregulla që respektohen në shtëpi?

AKTIVITETET EVALUATIVE

Nxënësit në çifte (ose grupe) e tregojnë këndin e tyre në shtëpi (që e kanë vizatuar) dhe bisedojnë për të (çka bëjnë, kush e rregullon etj.)

Treguesit e të arriturave

Nxënësi/nxënësja i emërton emrat e hapësirave në shtëpi, e di funksionin e tyre dhe mund të emërtojë pjesë të mobiljeve.

TEMA:SHTËPIA IME

Shembulli 9: Aparatura dhe mobilet në amvisëri

Qëllimet:Nxënësi/nxënësja të dijë dhe të emërtojë pjesë të mobilieve dhe aparaturës në shtëpi dhe përdorimi i tyre i drejtë.

Nacionet: aparatet/pajisjet në shtëpi,televizori, kompjuteri, shporeti elektrik, frigoriferi, radioja, mobilet.

Mjetet: fotografi me aparate/pajisje të shtëpisë dhe lodra-aparate në shtëpi dhe tregime të shkurta.

Vendi i realizimit: klasë.

Rrjedha e aktiviteteve

AKTIVITETET HYRËSE

Ora fillon duke shëtitur në klasë me qëllim që të shikohen mobilet në të. Mësimdhënësi bisedon me nxënësit në lidhje me mobilet që i kanë në shtëpi, mobilet në klasë dhe ngjashmëritë dhe dallimet ndërmjet tyre.

AKTIVITETET E MËSIMNXËNIES-MËSIMDHËNIES

Nxënësit ndahen në pesë grupe dhe në secilin grup ka ilustrime dhe lodër-aparat. Marrin detyrë të përgatiten për luajtje në role. Mësimdhënësi i lexon tregimet dhe i ndanë rolet. Secili grup duhet të prezantohet para nxënësve tjerë.

Tregimi1: „**Para televizorit**”.Të gjithë rrinë në dhomën e pritjes. Babai dëshiron të shikojë futboll, nëna film serik, ndërsa Damjani preferon filmat vizatimorë. E lusin televizori të vendosë. Ai zgjedh qëDamjani të shikojë film vizatimor, por me kusht çdo herë me kujdes të udhëheq televizorin.

Rolet: televizor, babai,nëna,fëmija.

Tregimi 2: „**Kompjuteri**. Goce dhe Filip janë vëllezër. Ata në shtëpi kanë kompjuter. Por, sot diskutojnë cili të ulet i pari para kompjuterit. Goce është i padurueshëm për të luajtur lojëra interesante. Filipi duhet të kërkojë të dhëna për në shkollë. Nëna doemos duhet dërgojë porosi për punën. Kompjuteri vendos dhe këshillon.

Rolet: kompjuter,fëmijë, nënë.

Tregimi3: „**Shporeti elektrik lavdërues**“. Shporeti elektrik lavdërohet se di të përgatisë të gjitha ushqimet në botë. Ai i pyet fëmijët çka dinë ata të përgatisin. Marija di të bëjë çaj, ndërsa Angela di të fërgojë vezë. Nëna e qorton shporetin elektrik të mos lavdërohet aq shumë, por duhet treguar fëmijëve si të ruhen nga rreziku kur punojnë me të.

Rolet: shporeti elektrik, fëmijë, nëna.

Tregimi 4: „**Radioja dhe CD-sistemi**”.Të shtunën bisedojnë radioja dhe CD-sistemi. Radioja është e mërzhitur sepse e kanë lënë në harresë, ndërsa ajo emiton shumë emisione të bukura për fëmijë, emisione informative dhe muzikore prej të cilave do të mësojnë shumë çka . Cd- sistemi qanë sepse Darko dhe Elena nuk kanë kujdes kur i përdorin ato, lëshojnë muzikë me zë të lartë dhe shpeshherë harrojnë ta ndalin. Darko dhe Elena premtajnë se do ta korrigojnë gabimin në sjellje.

Rolet: radioja, CD-sistem, Elena dhe Darko.

Tregimi 5:„**Frigoriferi i zemëruar**“:Në kuzhinë frigoriferi i ankohet shporetit elektrik sepse Petar e keqpërdorë ndonjëherë atë dhe e heq nga priza, ndonjëherë gërvisht akullin që të freskohet.Ndërsa Ivana shpeshherë nga shpejtimi i saj frigoriferin e lë të hapur. Ivana dhe Petar premtajnë se do ta korrigojnë gabimin në sjellje.

Rolet: frigorifer, shporeti elektrik, Ivana dhe Petar.

Treguesit e të arriturave: Nxënësit drejtë i emërtojnë aparatet/pajisjet në shtëpi dhe mund ta sqarojnë përdorimin e drejtë të aparaturës.

Tema: KOMUNIKACIONI

Shembulli 10: Shenjat e komunikacionit

Qëllimet: nxënësi/nxënësja të njohin shenjat e komunikacionit për këmbësorë dhe t'i respektojnë.

Nocionet kryesore: shenjat e komunikacionit

Mjetet: Programi për të vizatuar „Fotografi” nga softueri „Toollkid”, dy sllajde me shenjat e komunikacionit të përpunuara nga mësimdhënësi.

Vendi i realizimit: klasë me kompjuter

Forma e punës: në çifte

Rrjedha e aktivitetit

AKTIVITETET HYRËSE

Nxënësve ju tregohen një nga një sllajdet me shenjat e komunikacionit. Zhvillohet bisedë për formën, ngjyrën dhe rëndësinë e shenjave të komunikacionit për këmbësorë. Në shtojcë janë dhënë: sllajdi 1: „Ç’ka nënkuptojnë me këto shenja të komunikacionit”, sllajdi 2: „Shenjat e komunikacionit nuk duhet të dëmtohen”

AKTIVITETET E MËSIMDHËNIES – MËSIMNXËNIES

Nxënësit marrin udhëzim që të hyjnë në programin e të vizatuarit „Fotografi” nga „Toolkid” dhe të përpunojnë sipas dëshirës shenjë të komunikacionit për këmbësorë me kërkesë të mësimdhënësit nxënësit i emrojnë dhe i përshkruajnë shenjat e komunikacionit që i vizatojnë. Mësimdhënësi, sipas nevojës, ndihmon, i nxit nxënësit dhe i kurrajon për punën e tyre. Në fund nxënësit i përshkruajnë dhe i sqarojnë shenjat e komunikacionit që i kanë të vizatuara, të incizuara dhe të ruajtura në dosje.

AKTIVITETET EVALUATIVE

Në klasë vendoset qilimi i komunikacionit dhe shenjat e komunikacionit. Nxënësit ndahen në tre grupe, marrin aplikacione të makinave dhe e luajnë lojën Ne

jemi vozitës dhe këmbësorë. Duke u lëvizur si „makina” dhe „këmbësorë” e zbatojnë atë që e kanë mësuar.

Tregues të të arriturave:

Nxënësit/nxënësja njih disa shenja të komunikacionit dhe e tregojnë respektin e vetë në simulimin e situatës reale.

SHTOJÇË: Në rrugë: trotuar dhe rruga ndërmjet tyre

Katër sy



Gjyshja çdoherë i thoshte Jonës:

-Jona hapi katëçr sy kur e kalon rrugën!

Jona e dinte që gjyshja i thot këto fjalë atëherë kur duhet të kemë shumë kujdes.

- Gjyshe, por unë kam vetëm dy sy , bëri shaka Jona.

Kur do arrish para vendkalimit të rrugës shiko majtas – djathtas dhe pastaj kaloe rrugën. Nëse nuk ke kujdes mund të ndodhë fatkeqësi. Prandaj të them të hapish katër sy.




- Gjyshe ti çdoherë ke të drejtë: - tha Jona.

Çka paraqesin këto shenja të komunikacionit ?



Duhet të nadlesh
Kur STOP! të thot.
Prit dhe shiko
këshillave mos ju
largo.





Shembuj të shenjave të komunikacionit nga nxënësit në programin „Tollkid”-shenjat e komunikacionit

Tema: KOMUNIKACIONI

Shembulli i 11: Ku dhe si mundem ta kaloj rrugën?

Qëllimet: nxënësi/nxënësja të dijë të lëvizë drejtë dhe sigurt në rrugë dhe rrugicë si dhe të dijë të zgjedh ku të luajnë, të dijë se si kalohet udhëkryqi.

Nacionet kryesore: rrugë, rrugicë, vend për të luajtur, udhëkryq dhe shenja të komunikacionit

Mjetet: fotografi ose sllajde në programin Payer poin dhe shkres e zëshme

Vendi i realizimit:klasë me kompjutor

Rrjedha e aktivitetit

AKTIVITETET HYRËSE

Nxënësve u tregohen fotografi ose sllajde nr.1. u parashtrohen pyetje hyrëse me të cilët do të paraqiten aktivitete gjatë orës. Për gjithçka që duket në sllajd nxiten fëmijët që të vërejnë dhe të bisedojnë.

AKTIVITETET E MËSIMDHËNIES - MËSIMNXËNIES

Përmes sllajdeve dhe bisedave të paraqitura nxënësit duhet të kuptojnë se si të lëvizin drejtë dhe sigurtë në rrugë. Nxënësit sqarojnë, interpretojnë dhe zgjedhin situata të komunikacionit që janë të paraqitura në sllajde. Flitet për atë se si kalohet rruga e caktuar dhe a pacaktuar me shenja, që u ndihmon fëmijëve në komunikacion dhe ku munden të luajnë.

AKTIVITETET EVALUATIVE

Nxënësit flasin për situatat e paraqitura të komunikacionit dhe zbulojnë se kush ka kaluar drejt, e kush padrejtë.

Treguesit e të arriturave

Nxënësi/nxënësja njeh udhëkryqin dhe në situata të simuluar tregon kalimin e tij, si dhe lëvizje të drejtë dhe të sigurt.

Shenjat e komunikacionit nuk duhet të dëmtohen. Pse?



Shenjat në rrugë
duhet të
respektohen.
Porosinë e tij secili ta
respektojë



Fëmijët para semaforit

Përshkruaje semaforin.



Semafor i thonë
Tre sy i ka
Me orar punon
Të ndaluar s'ka

Dy sy pushojnë
Njëri punon
Çka duhet të bëjmë
Ai na tregon

Sa lodhe ai
Thotë vazhdo vëlla
Edhe rruga tjetër
Nevojë ka

Xhaxhin polic
Se lag borë e shi
Me rrymë punon
SEMAFORI

Në udhëkryq

- Si do ta kalosh rrugën në udhëkryq me semafor?
- Cilët këmbësorë në fotografi bëjnë gabime në komunikacion?
- Cili këmbësor lëviz sipas rregullës?



Kush i ndihmon fëmijët në komunikacion?


Anila e vogël
Në shkollë kur shkon
Një xhaxhe polic
Rrugën ia kalon

Me kapelë e dorëza
Në udhëkryq qëndron
Dhe për disa çaste
Semaforin zëvendëson

Kaloni fëmijë
Unë ju siguroj
Sa ju të kaloni
Makonat do t'i lëshoj



Mbaje mend: Rruga dhe rrugica nuk janë vend për lojë



Shtojcë: përshkrim i zëshëm

- Polici thotë: - „Mund ta kaloni rrugën”.
- Polici ka të drejtë t’ju thotë të tjerëve se ç’ka të bëjnë dhe se si të sillen në komunikacion.
- Atë të drejtë ia jep puna dhe ligji.

Shtojcë: përshkrim i zëshëm

- Polici thotë: „Mund ta kaloni rrugën”.
- Polici ka të drejtë t’ju tregojë tjerëve se çka të bëjnë dhe se si të veprojnë në komunikacion.
- Atë të drejtë ja jep puna dhe ligji.

Miloti ka qen të bukur. Të gjithë fëmijët nga rruga e duan dhe luajnë me atë. Një ditë qeni u largua nga fëmija. Shkoi në rrugë. Dhe Miloti vrapoi pas tij. Menjëherë ndodhi britmë. Vetura frenoi në moment. Fëmijët u frikësuan. Qeni qëndronte në rrugë, kurse vozitësit e shikonin të hidhëruar.

(tekst i përshtatur nga Libri i leximit për klasën e I.- S. Adamçevska)

V. SHEMBUJ TË AKTIVITETEVE SIPAS TEMAVE MËSIMORE PËR KLASËN E III -të

Lënda mësimore *Shoqëri* në klasën e tretë në arsimin e ri fillor nëntëvjeçar është e përfshirë me 1 orë në javë, gjegjësisht 36 orë në vit. Në program janë përfshirë temat në vijim: *Unë me të tjerët dhe të tjerët me mua; Shkolla dhe dituria; Raportet në familje; Vendlindja ime dhe Komunikacioni.*

TEMA: UNË ME TË TJERËT DHE TË TJERËT ME MUA

Shembulli 1: Unë dhe ti, ne dhe ju

Qëllimet: nxënësi/nxënësja të dijë se njerëzit të cilët jetojnë dhe punojnë bashkërisht krijojnë raporte të caktuara mes tyre (dashuri, respekt, kujdes, besim në miqësi, bashkëpunim).

Nocionet kryesore: bashkëpunim, shoqërim, respektim.

Mjetet: fletë për vizatim, brushë dhe ngjyra të ujit, kartuq me shenja të grupeve.

Vendi i realizimit: klasë.

Rrjedha e aktivitetit

AKTIVITETET HYRËSE

Loja: Formohet grup prej 8 nxënës të cilët kapen krahë për krah dhe formojnë rreth sa më të ngushtë, kështu që ndërmjet tyre nuk ka vend të zbrazët. Një nxënës gjendet jashtë rrethit dhe përpiqet të hyjë brenda në rreth (ata të cilët e kanë formuar rrethin nuk guxojnë ta lëshojnë të hyjë brenda). Nxënësit tjerë janë „vëzhgues” dhe i vërejnë strategjitë që i shfrytëzon ai që ndodhet jashtë rrethit dhe ata të cilët e formuan rrethin. Pas një kohe të caktuar pa marr parasysh atë se vallë nxënësi jashtë rrethit ka arritur sukses të hyjë në rreth ose jo, ai shoqërohet në rreth. Një nxënës tjetër del jashtë rrethit. Loja përsëritet disa herë. Dëgjohen rrëfimet e „vëzhguesve”.

Vijon **diskutimi**. Mësimdhënësi i pyet nxënësit si janë ndje mbrenda në rreth dhe si kur janë jashtë rrethit. Mësimdhënësi i pyet se si kanë bashkëpunuar nxënësit nga rrethi, si sillen ndaj individit, si janë respektuar. Mësimdhënësi bisedon me nxënësit për atë se të gjithë ne i takojmë disa bashkësive (psh.: jetojmë në ndërtesë të njëjtë ose rrugë dhe jemi fqinjë, jetojmë në një qytet dhe jemi bashkëqytetarë, jetojmë në R. e Maqedonisë dhe të gjithë jemi shtetas të R. së Maqedonisë. Të gjithë ne, deshëm ose jo, jemi pjesëtarë të disa bashkësive, jetojmë dhe punojmë së bashku.

AKTIVITETET E MËSIMDHËNIES-MËSIMNXËNIES

Punëtorja: me numërim nxënësit ndahen në pesë grupe dhe secili grup merr emrin e ndonjërës bashkësi, kurse nxënësit janë anëtarë të asaj bashkësie.

Grupi 1: **Shokë** që jetojnë në rrugë të njëjtë.

Grupi 2: **Bashkënxënës** të paraleles.

Grupi 3: **Bashkëqytetarë** të klubit sportiv.

Grupi 4: **Adhures** të kafshëve

Grupi 5: **Bashkëpunëtorë** të seksionit figurativ.

Secili grup merr detyrë në fletën e punës.

FLETË PUNE:

1. Mendoni tre aktivitete të cilat do t'i kishit bërë në bashkësinë tuaj për të ndihmuar në raportet e tyre reciproke (të respektoheni, të bashkëpunoni, të shoqëroheni, të kujdeseni për diçka ose për ndonjërin).

2. Në fletë të bllokut bëni një pikturë të përbashkët në grup. Secili në mënyrë individuale, pasi të merr ndonjërin nga ngjyrat me brushë, me një lëvizje të dorës të bëjë gjurmë në fletë të bllokut.

AKTIVITETET EVALUATIVE

Secili grup paraqitet me pikturat e bëra dhe i prezanton aktivitetet që i kanë shkruar, dhe vallë do t'i kishin bërë për bashkësinë e tyre. Pastaj përmes bisedës konkludohet se njerëzit formojnë bashkësi për të pasur jetë më të mirë. Mësimdhënësi i pyet nxënësit si iu ka pëlqyer puna e përbashkët, çka ishte interesante gjatë punimit të pikturës së përbashkët. Secili grup merr lavdatë për bashkëpunimin e tyre dhe respektin e treguar gjatë kohë derisa punohet.

Treguesi i të arriturave

Nxënësi/nxënësja mundën tëtregojn së paku një shembull të dashurisë, respektit, kujdesit, besimit dhe shoqërimit ndërmjet njerëzve që jetojnë dhe punojnë sëbashku.

TEMA: UNË ME TË TJERËT DHE TË TJERËT ME MUA

Shembulli 2: Të drejtat dhe obligimet e mija

Qëllimet: Nxënësi/nxënësja

- t'i përthellojë njohuritë për disa të drejta themelore të fëmijëve.
- të njihet me shërbimet dhe njerëzit që ndihmojnë të realizohen të drejtat e fëmijëve dhe t' mbrojnë të drejtat e tyre.

Nocionet kryesore: e drejtë, UNICEF.

Mjete: filma vizatimor nga UNICEF-i në kohëzgjatje prej 30 sek., LCD-proektor dhe kompjuter, afishe për të shkruar të drejtat e fëmijëve lidhur me filmat vizatimor.

Përgatitja paraprake e mësimit: mësimit në adresën e dhënë në internet paraprakisht i shqyrton të gjitha nenet e ofruara nga Konventa për të drejtat e fëmijës dhe zgjedh disa prej tyre që do tua sqarojë nxënësve. (Adresa: www.youtube.com., shkruhet UNICEF cartoon, zgjedhet filmi :” a BARCA cartoon for UNICEF” mandej për secilin film shkruhet neni i dëshiruar: Psh. Article 9/10, paraqiten video- përshkrime të shumta, kurse mësimit e zgjedh filmin vizatimor për të drejtën adekuate.

Vendi i realizimit: klasë.

Rrjedha e aktivitetit

AKTIVITETET HYRËSE

Në videobim paraqitet filmi vizatimor: „a BARCA cartoon for UNICEF”. Mbahet kuadri me emblemën e UNICEF-it dhe nxënësit e përshkruajnë dhe sqarojnë shenjën. Flitet për kujdesin dhe ndihmën e fëmijëve në botë, emërtohen disa personalitete të njohura të cilët janë të emërtuar për ambasadorë të nderuar të UNICEF-it. Pastaj nxënësit ndahen në grupe, secili grup fiton plakatë dhe flomaster. Nxënësve iu paralajmërohet se do të shikojnë filma të shkurtë të animuar për të drejtat e fëmijëve.

AKTIVITETET MËSIMDHËNËSE - MËSIMNXËNËSE

Nxënësve iu sqarohen filmat vizatimor një nga një, të përcjellur me muzikë. Pas secilit film të parë vijon biseda me përmbajtjen dhe sqarime dhe komentime të porosisë të secilës të drejtë të fëmijës. Për shembull: Për filmin Article 9/10: “Për fëmijët duhet të kujdesen prindërit e tyre. Nxënësit debatojnë, shprehin mendimet e tyre. Sjellet konkludim, dhe pastaj nxënësit e secilit grup e tregojnë të drejtën në afishe. Kjo përsëritet me 4-5 filma vizatimor. Dhe në mënyrë adekuate me kadret nga filmi dhe porositë, bisedohet me nxënësit. Për këtë orë janë zgjedhur koto filma vizatimor:

Article 9/10 (neni 9/10) Për fëmijët duhet të kujdesen të dy prindërit. Article 28 (neni 28) Fëmijët kanë të drejtë të mësojnë dhe të shkollohen. Article 15 neni 15) Fëmijët kanë të drejtë të shoqërohen mes tyre.

Article 7 neni 7) Fëmijët kanë të drejtë për emër, mbiemër, datëlindje dhe shtetësi.

Article 24 (neni 24) Fëmijët kanë të drejtë të jenë të shëndoshë.

AKTIVITETET EVALUATIVE

Afishet e shkruara me të drejtat e fëmijëve ngjiten në muret e klasës. Nxënësit edhe një herë i lexojnë të drejtat e fëmijëve dhe tregojnë se çka iu ka lënë mbresë më të madhe nga filmat e spjeguar.

Në fund të aktivitetit zhvillohet bisedë me nxënësit për atë se të rriturit duhet ta bëjnë atë që është më së miri për fëmijët dhe shpjegohet filmi vizatimor. : Article 3. Nxjerret konkludimi: **Secili fëmijë ka të drejtë ti dijë të drejtat e veta.**

Treguesi i të arriturave

Nxënësi nxënësja i di të drejtat dhe i sqaron me fjalët e veta.

TEMA: UNË ME TË TJERËT DHE TË TJERËT ME MUA

Shembulli 3: Respektimi i dallimeve

Qëllimet: nxënësi/nxënësja të nxitet që ti respektojë dallimet (gjininë, pamjen e jashtme).

Mjete: fletë për të shkruar dhe vizatuar, ngjyra druri, flomasterë ose shkumës me ngjyra, kartuça me numra për grupet.


Nocione: respektimi.

Vendi i realizimit: klasë.

Rrjedha e aktivitetit

AKTIVITETET HYRËSE

Nxënësit ndahen në dy grupe: grupi i vajzave dhe grupi i djemve. Grupi i vajzave merr detyrë të mendojë dhe në letër ti shkruajë ato lojëra të cilat më së shpeshti i luajnë djemtë. Grupi i djemve merr për detyrë ti shkruajë ato lojëra të cilat më së shpeshti i luajnë vajzat. Pastaj një anëtar i grupit e lexon para të tjerëve atë që e kanë shkruar. Anëtarët e grupit tjetër dëgjon me vëmendje dhe përderisa ka ndonjë lojë e cila nuk është përmendur, e tregon. Në këtë mënyrë grupet plotësohen njëri me tjetrin. Rrëfimet e tyre mësimdhënësi i shkruan në tabelë duke përdorë diagramin e Venit. Në mes të diagramit të Venit i shkruan ato lojëra që i kanë të përbashkëta, përkatësisht lojëra për të cilat janë deklaruar edhe vajzat edhe djemtë.



Përfundim: edhe pse dallohem për nga gjinia djem/vajza, të gjithë jemi nxënës dhe loja është aktivitet i preferuar i të gjithëve sepse na mundëson shoqërim mes veti.

AKTIVITETET E MËSIMNXËNIES-MËSIMDHËNIES

Hapi i parë: Nxënësit marrin detyrë të vizatojnë lule me pesë gjethe. Në mes të lules e shkruajnë emrin e vet, ndërsa në gjethet e lules nga një karakteristikë të tyre e cila i karakterizon dhe përmes së cilës janë të njohura.

Mësimdhënësi i nxit nxënësit të mendojnë dhe e orienton mendimin e tyre ndaj karakteristikat e personalitetit, e jo ndaj dëshirave të tyre, aktivitete ose pamje të jashtme. Ai iu propozon nxënësve gjethet ti vizatojnë me ngjyra të ndryshme, përkatësisht cilësitë përmes të cilave janë të njohura, dmth, karakteristikat të cilat i zbukurojnë ti shkruajnë në ngjyrë përkatëse të gjethit. Pastaj të bëjnë hapësirë për të shkruar.

Hapi i dytë: Pasi ti kanë shkruar gjethet nxënësit ndahen në grupe (katër ose gjashtë) varësisht nga numri i përgjithshëm i nxënësve në paralele.

Nxënësit mes veti këmbejnë dhe kontrollojnë vallë ka gjethe të lules me veti dhe karakteristik të njëjta të shënuara të personave. Në qoftë se paraqitet diçka e tillë në gjethin e lules shkruhet emri i shokut/shoqes. Pastaj bashkohen dy me dy grupe (grupi i parë me të tretin, i dyti me të katërtin) dhe detyra përsëritet ndërsa gjethet e lules plotësohen me emra të nxënësve të cilët kanë karakteristika të njëjta. Kjo përsëritet deri atëherë ku secili me secilin nuk bie në kontakt dhe i ndanë karakteristikat e veta të shkruara.


AKTIVITETET EVALUATIVE

Mësimdhënësi zhvillon bisedime me nxënësit për atë se si kanë punuar, me çfarë ndjenja, vallë ka lule me shkrime të ngjashme. Cilën karakteristikë e keni hasur te shumica e nxënësve (nxënës të klasës së tretë të cilët mësojnë në shkollë të njëjtë, jetojnë në qytet të njëjtë etj.)? Ajo është diçka e përbashkët, por secila lule është e ndryshme dhe në veçanti-

kjo i flet për atë se secili fëmijë është i veçantë. Në mbarim mësimdhënësi në letër poster ose në tabelë vizaton lule të re në mesin e së cilës i shkruan ato shënime dhe karakteristika të cilat sipas shqyrtimeve të nxënësve janë të përbashkëta, ndërsa në gjethet e lules të gjithë ato të cilët dallojnë. Gjatë kësaj duhet pasur kujdes ti shkruajë me flomaster/shkumës me ngjyrë.

Treguesit e të arriturave

Nxënësi/nxënësja munt të tregoj shembull të respektimit të dallimeve në kuptim të gjinis dhe pamjes së jashtme



TEMA : SHKOLLA DHE DITURIA

Shembulli 4: Mësojmë , dimë

Qëllimet: nxënësi/nxënësja të fitojë njohuri se mësimi është i rëndësishëm për zhvillimin personal.

Nacionet kryesore: shkolla, dituria.

Mjetet: fleta të mëdha të letrës të vendosura në tabelë.

Vendi i realizimit: klasë.

Rrjedha e aktivitetit

AKTIVITETET HYRËSE

Nxënësit ulen në rreth dhe zhvillohet bisedë për pyetjet në vijim: Pse nxënësit vijnë në shkollë? Çka paraqet shkolla? Çka mësojnë në shkollë? Nxjerret përfundimi se në shkollë fitohet dituria, por gjithashtu, fëmijët mësojnë se si të jetojnë sëbashku, si të bashkëpunojnë, të zgjidhin probleme të përbashkëta, ta përmirësojnë jetën e tyre në shkollë, familje, në mjedisin në të cilin jetojnë.

AKTIVITETET E MËSIMDHËNIES - MËSIMNXËNIES

Vihet një letër e madhe në tabelë dhe mësimdhënësi pyet: Pse duhet të mësojmë? I shkruan të gjitha mendimet- rrëfimet e nxënësve.

Pastaj parashtron pyetje: Për çka do të dëshironi të mësoni në shkollë? Mësimdhënësi i shkruan rrëfimet e nxënësve.

Në fletë shkruan pyetjet: Prej ku mësojmë? I shkruan të gjitha rrëfimet të nxënësve. Përmbledhen/sumohen rezultatet nga rrëfimet e shkruara dhe nxjerren konkludimet.

AKTIVITETET EVALUATIVE

Secili nxënës e pranon detyrën në listë të veçantë që të vizatojë çfarë shkolle do të kishte dëshiruar të ketë dhe të shkruaj diçka lidhur me dëshirat e tija për shkollën, çka dëshiron të mësojë etj.

Treguesit e të arriturave

Nxënësi/nxënësja me fjalët e vete sqaron pse është i rëndësishë mësimi për zhvillimin personal të secilit nxënës.

TEMA : SHKOLLA DHE DITURIA

Shembulli 5: Si është e organizuar klasa ime?

Qëllimet: Nxënësin/nxënësja të merr pjesë në punën dhe detyrat e bashkësisë së klasës dhe sjelljen e vendimeve të bashkësisë së klasës.

Mjete: teksti me përmbajtje përkatëse, fleta për të shkruar rregullat, hamer ose letër poster.

Nocionet: bashkësia e klasës.

Vendi i realizimit: klasë.

Rrjedha e aktiviteteve

AKTIVITETET HYRËSE

Leximi i tekstit me titull: **Piknik në mjedis të afërt**

Një kohë të gjatë nxënësit: Marko, Mimoza, Denis dhe Rina mendojnë për një piknik të përbashkët në mjedisin e afërt. Pas bisedimeve të gjata ata vendosën ta vizitojnë vendin Kodra e Diellit e pasur me luanth, me begati të drunjve dhe luleve. I filluan përgatitjet me gëzim dhe lumturi. Rrugës deri te vendi i caktuar kaloi me disponim të mirë. Pikniku mund të fillonte. Por së pari duhej të bëhej radhitja për atë kush ku do të vendoset në luanth. Secili nga fëmijët dëshironte qilimin e vet ta vendosë nën hijen e dushkut.

- Unë jam më i madh dhe unë vendosi kush ku të vendoset dhe çka të bëjë.
- i pari u paraqit Marko.
- Neve nuk na nevojitet ndokush i cili do të na urdhërojë! - tha Mimoza
- Unë dëshiroj të dëgjohet edhe mendimi im - tha Denisi

Rina qëndronte anash dhe po mendonte.: Si do të vijojë ky shoqërim? Si do t'iu ndihmojë shokëve/shoqeve të saj?

Diskutimi vijon. Çka mendoni, cili mendon ashtu siç duhet? Çfarë do të bënit ju po të ishit në vendin e tyre? Çka iu nevojitet këtij grupi të vogël të fëmijëve që pikniku në mjedisin e afërt të vijojë pa problem?

AKTIVITETET E MËSIMNXËNIES-MËSIMDHËNIES

Mësimdhënësi i përkujton nxënësit se paralelja paraqet një bashkësi të përbërë nga nxënësit. Që ajo të funksionojë mirë nevojiten rregulla.

Nxënësit ndahen në grupe. Secili grup merr detyrë:

Grupi i parë: me marrëveshje të përbashkët të sjellin rregulla për imazh më të mirë të klasës (rregullimi i klasës, radhitja dhe begatia e këndeve etj.).

Grupi i dytë: me marrëdhënie të përbashkët të sjell rregulla për mirëkuptim mes tyre (të dëgjohet shoku/shoqja, respekto mendimin e saj/tij, flitë të vërtetën etj.).

Grupi i tretë: me marrëveshje të përbashkët të sjell rregulla për sjelljen në klasë gjatë orëve (mos flit me zë të lartë, mos i përdorni celularët gjatë orëve në klasë etj.).


Grupi i katërt: me marrëveshje të përbashkët të sjell rregulla për sukses më të mirë në paralele (sqaro nëse di , tregohu nëse mundesh, trego çka di etj.).

AKTIVITETET EVALUATIVE

Secili grup zgjedh përfaqësues i cili do ti lexojë rregullat e shkruara nga grupi i tij. Në qoftë se ato pranohen nga nxënësit tjerë të paraleles vihen në një vend të dukshëm në klasë.

Treguesit e të arriturave

Nxënësi/nxënësja mundet të marr pjes në punën e bashkësisë së klasës dhe mund të numëroj disa vendime të sjella në bashkësinë e klasës.



TEMA: MARRËDHËNIET NË FAMILJE

Shembulli 6: Të afërmit

Qëllimi: nxënësi/ nxënësja të merr njohuri për të afërmit e tij, t'i dallojë, njohë dhe emërtojë, t'ikuptojë raportet mes tyre.

Nocionet kryesore: të afërmit: xhaxhai, gruaja e xhaxhait, daja, gruaja e dajës, tezja, burri i tezes, kusherirët

Mjetet: fletë pune.

Përgatitja paraprake e nxënësve: fotografitë nga të afërmit.

Vendi i realizimit: klasë.

Rrjedha e aktivitetit

AKTIVITETET HYRËSE

Mësimdhënësi bisedon me nxënësit për atë se secili njeri ka familje, por ka edhe të afërmit e tij. I lëvdëron që janë munduar të sjellin disa fotografi nga të afërmit e tyre.

AKTIVITETET E MËSIMDHËNIES - MËSIMNXËNIES

Në pano mësimdhënësi e shpall afishen me vargje të shkruara:

Unë kam xhaxha
Vëllai i babës tim,
Ndërsa zonja Lina,
është gruaja e tij.

Pastaj nxënësit të cilët kanë xhaxhallarë u lejohej të thonë diçka për ata, si quhen, ku jetojnë, cilët janë anëtarët e familjes së tyre. Vendoset afishe në të cilën ka sërish vargje të shkruara. Nga nxënësit kërkohet t'i lexojnë vargjet dhe në vizat e zbrazëta t'i shtojnë fjalët përkatëse, të cilat do t'i zgjedhin nga fjalët e dhëna më poshtë.

Unë kam dajë
që është vëllau i _____,
ndërsa zonja Tringë
është _____ e tij.

(nëna ime, baba im, gruaja e xhaxhait, gruaja e dajës, tezja)

(Bisedohet edhe për këtë lidhje familjare ngjajshëm si për të kaluarën, shqyrtohen edhe disa nga fotografitë e sjellura. Pastaj nxënësit që kanë dajallarë ftohen të thonë diçka për ata, si quhen, ku jetojnë, cilët janë anëtarët e familjes së tyre.

Vendoset edhe afishja e tretë me vargje në të cilën nxënësit duhet ta plotësojnë fjalën e lëshuar. Nxënësit së bashku e lexojnë strofën dhe e plotësojnë.

Motra e nënës
është tezja Blerta,
ndërsa motra e babës
është ___ Kanita.

Bisedohet për lidhjet familjare, nxënësit i emërtojnë dhe i ndajnë tezet sipas nënës dhe sipas babës. Në fund shpallet afishe me vargje, ku sërish duhet të plotësohen vijat e zbrazëta nga ana e nxënësve.

Daja dhe _____,
gruaja e xhaxhait _____
Tezja dhe _____,
janë pesë kushurinjtë mij
të gjithë më janë në numër
dhe janë të dashurit e mij.

AKTIVITETET EVALUATIVE

Aktivitetet në listën punuese ku nxënësit në retë i shkruajnë emrat e familjes më të afërt nga nëna dhe babai.

Shtojcë – fletë pune nr. 1

Treguesit e të arriturave

Nxënësi/nxënësja i sqarojnë lidhjet familjare (xhaxha, grua e xhaxhait, daja, grua e dajës, teza, burie tezes, kusherinjtë.

TEMA: MARRËDHËNIET NË FAMILJE

Shembulli 7: Profesione

Qëllimet: nxënësi/nxënësja ti tejkalojë stereotipat gjinore në lidhje me profesionet.

Nocionet kryesore: profesioni.

Mjete: një lëmsh prej leshi ose litar, kuti, kartuça me ngjyra, letër, laps.

Vendi i realizimit: klasë.

Rrjedha e aktiviteteve

AKTIVITETET HYRËSE

Loja: Nxënësit qëndrojnë në rreth dhe thurin rrjet . Rrjeti thuret në atë mënyrë që lëmshi qëndron në duart e njërit nxënës i cili , në fakt e fillon lojën.

Nxënësi i cili në duar mban lëmshin tregon një profesion, përkatësisht atë që dëshiron ta ketë kur të rritet. Pasi ta tregojë këtë e mban fijen e fillimit të lëmshit dhe lëmshin ia hedh fëmijës tjetër i cili gjendet përballë tij/saj në rreth. Veprimi përsëritet në tërësi përderisa të gjithë nxënësit nuk i tregojnë mendimet e tyre, ndërsa rrjeti do të jetë i thurur.

AKTIVITETET E MËSIMNXËNIES- MËSIMNXËNIES

Në mes të rrethit vendoset kutia në të cilën ka kartela në të cilat janë të shkruara profesione të llojllojshme (voztës, kuzhinier, floktar, mjek, bukëpjekës, elektrikist, shkencëtar etj. Secili nxënës ka mundësinë të tërheq një kartelë, ta lexojë profesionin para nxënësve tjerë dhe ta përcjellë mendimin e vet në lidhje me atë vallë profesioni i takon gjinisë femërore ose asaj mashkullore. Përderisa mendon se është profesion femre vendoset në anën e djathtë, në qoftë se mendon se është profesion mashkull – vendoset në anën e majtë, dhe në qoftë se mendon se është e njëjtë dhe mund ta punojnë të dyja gjinitë - kthehet në vendin e vet në rreth.

Pasi të gjithë nxënësit do të tërheqin kartelë dhe do të pendohen për mendimin e tyre sa i përket profesioneve të ndara zhvillohet debat. Ku ka më tepër nxënës , në anën e majtë ose në anën e djathtë të klasës? Sa nxënës janë kthyer në rreth? Çka na tregon kjo situatë? Nuk ka profesione për femra-për meshkuj. Secili mund të punojë atë që dëshiron. Ekzistojnë edhe profesione të tilla që më së shumti i punojnë femrat , por edhe të tjera që i punojnë meshkujt.

AKTIVITETET EVALUATIVE

Secili nxënës/nxënëse në fletë letre duhet ta shkruajë profesionin i cili/e cila , zgjedhja e tij/e saj dhe vallë atë profesion mund ta punojnë edhe meshkujt edhe femrat.

Treguesit e të arriturave

Nxënësi/nxënësja numërojnë më shumë profesione me të cilat mun të merren edhe femrat edhe meshkujt.

TEMA: MARRËDHËNIET NË FAMILJE

Shembulli 4: Ku jetoj

Qëllimet: nxënësi/nxënësja t'i studiojë karakteristikat themelore të shtëpisë dhe të dijë ta përshkruajë shtëpinë e vet.

Nocionet kryesore: shtëpi, banesë, kujdes.

Mjetet: afishe me skemë „Ku jetoj „.

Përgatitja paraprake e nxënësve: të mbledhin disa të dhëna të ndërlidhura me këto pyetje: Ku gjendet? Si duket? Cilat hapësira i ka në shtëpi? Të bisedojnë me prindërit për ndarjen e aktiviteteve dhe kujdesit për shtëpinë

Vendi i realizimit: klasë.

Rrjedha e aktivitetit

AKTIVITETET HYRËSE

Mësimdhënësi i orienton nxënësit për atë se çfarë kanë vërejtur gjatë vëzhgimit në shtëpinë e tyre, kush dhe si kujdeset për rendin dhe higjienën në shtëpi.

AKTIVITETET E MËSIMDHËNIES - MËSIMNXËNIES

Lexohen pyetjet nga skema e afishes së shpallur dhe mësimdhënësi i orienton nxënësit si ta përshkruajnë shtëpinë e vet në letrën e dhënë. Mësimdhënësi i përcjellë aktivitetet e nxënësve dhe sipas nevojës i nxit dhe i korrigjon.

AKTIVITETET EVALUATIVE

Disa nga nxënësit e lexojnë përshkrimin e tyre të shtëpisë në të cilën jetojnë.

Treguesit e të arriturave:

Punimet e nxënësve në të cilat është përshkruajtur shtëpia në të cilën jetojnë.

TEMA: VENDLINDJA IME

Shembulli 8: Vendlindja ime ka të kaluarën e vet

Qëllimet: nxënësi/nxënësja të njihen me ngjarjet më të rëndësishme historike në atdheun e tyre.

Nacionet kryesore: historia, e kaluara, personazhe të historisë.

Mjetet: shiriti I kohës: shirit prej kartuqi (6-7 cm. i gjërë, rreth 2 m i gjatë), Tekste të shkurtëra, enciklopedi, fotografi me personazhe historike.

Përgatitja paraprake: Aktiviteti hulumtues: nxënësit janë të ndarë në grupe dhe secili prej tyre duhet të sjell me vete: fotografi, tekst të nxjerrur ose raport të shkurtër nga biseda e zhvilluar me të rriturit/moshuarit në familje. (grupi 1 për personazhet e LNÇ, grupi 2 për Goce Delçevin, grupi 3 për Mbretin Marko, grupi 4 për Mbretin Samuil, grupi 5 për Kirilin dhe Metodin, grupi 6 për Aleksandrin e Maqedonisë.)

Vendi i realizimit: klasë.

Rrjedha e aktivitetit

AKTIVITETET HYRËSE

Mësimdhënësi bisedon me nxënësit për atë se secili njeri, secili qytet, vend, ka të kaluarën, të tashmen dhe ardhmërinë e vet. Përmes bisedës nxënësit duke folur për vetveten, tash për atë kur kanë qenë të vegjël dhe çka dëshirojnë të bëhen kur do të rriten, njihen me nocionet të tashmen, të kaluarën dhe ardhmërinë. Mësimdhënësi thekson se koha mund të shpjegohet apo prezantohet me një shirit të gjatë i cili nuk ka as fillimin e as mbarimin. Shiritin e vendos në panon ose në mur dhe mbi shiritin i ngjet fjalët e shkruara paraprakisht: e kaluara e largët, e kaluara, e tashmja dhe e ardhmja (largesa është menduar paraprakisht).

AKTIVITETET E MËSIMDHËNIES - MËSIMNXËNIES

Prezantohet pjesa nga shiriti që tregon për të tanishmen, kohën në të cilën jetojmë. Nxënësit me kërkesë të mësimdhënësit emërtojnë personazhe të njohura nga përditshmëria e atdheut të tyre (në fletë nën shiritin shkruan disa emra të këngëtarëve, aktorëve, politikanëve). Në pjesën nën e ardhmja ngjet fletë të zbrazët, që të tregohet se ajo gjendet para nesh dhe na pret. E shikojnë shiritin në të cilin për të kaluarën ka të vendosur pjesë më të madhe të shiritit. Mësimdhënësi bisedon me nxënësit se e gjithë ajo që ka ndodhur në të kaluarën është e lidhur me disa personalitete që e kanë krijuar historinë tonë. Mbi shiritin e kohës ngjet shirit me fjalën "historia". Pastaj sipas radhitjes kronologjike kthehet në të kaluarën. Mësimdhënësi dhe nxënësit bisedojnë për personalitetet dhe

ngjarjet të lidhura me ato. Mësimdhënësi i ngjet fotografitë e personaliteteve nën shiritin e periudhës kohore.

AKTIVITETET EVALUATIVE

Pasi të përpunohet shiriti i kohës, mësimdhënësi dhe nxënësit përsëri e shikojnë dhe i vërejnë personalitetet dhe ngjarjet të lidhura me ato sipas radhitjes së ngjarjeve. Theksohet se ngjarjet me Aleksandrin e Maqedonisë i përkasin të kaluarës së largët. Në të kaluarën e largët ka pasur shumë ngjarje dhe personalitete ndërsa historianët ato i kanë studjuar.

Treguesit e të arriturave.

Nxënësit flasin për personalitetet dhe ngjarjet më të rëndësishme në atdheun e tyre dhe kanë njohuri për radhitjen kronologjike të ngjarjeve.

SHTOJCË:

SHIRITI I KOHËS

H I S T O R I A

e kaluara
e largët

koha e

e tashme
2000 - 2008 e
ardhme




Aleksandar
Makedonski



Skender
beu
Goce
Delevi



Naim F.
Kirili dhe
Metodi



TEMA: VENDLINDJA IME

Shembulli 7: Bukuritë e komunës time dhe vendlindjes time

Qëllimet: Nxënësi/nxënësja t'i emërton pasuritë natyrore të vendlindjes, të vendit të vet.

Nocionet kryesore: pasuritë natyrore, atdheu.

Mjetet: kartolina me pasuri dhe bukuri natyrore nga vendlindja dhe atdheu. Programi për kombinim të informative "Stripe" nga softveri "ToolKid" harta gjeografike e R. së Maqedonisë.

Vendi i realizimit: laboratoria kompjuterike.

Rrjedha e aktivitetit

AKTIVITETET HYRËSE

Mësimdhënësi ua tregon hartën gjeografike të R. së Maqedonisë dhe i pyet nxënësit sipas së cilës e njohin hartën e atdheut të tyre. Parashtrohen pyetje nxënësve ku gjendet vendi i tyre i lindjes (fshat, qytet), komuna e tyre. Nxënësit tregojnë nëse dijnë, e nëse jo këtë e tregon mësimdhënësi. Zhvillohet bisedë për atë se cilat bukuri natyrore gjenden në mjedis dmth., në komunë dhe më gjërë. Cilat bukuri natyrore i posedon Maqedonia.

Mësimdhënësi u tregon nxënësve se duhet të bëjnë album prej 3 faqeve me temë "Bukuritë e vendlindjes".

Mësimdhënësi i përkujton nxënësit për punën në programin për kombinimin e informatave "stripeve". I përkujton për atë se si menaxhohet me veglat për të shkruar tekst, fotografi etj. Pastaj ua shpërndan fletat e punës.

AKTIVITETET E MËSIMDHËNIES-MËSIMNXËNIES

Nxënësit punojnë në çifte në detyrat e fletës së punës. Mësimdhënësi i përcjell aktivitetet e nxënësit, kurse sipas nevojës, u ndihmon, i orienton dhe i korrigjon.

Albumi i përpunuar me temë: "Pasuritë e vendlindjes" nxënësit e ruajnë (duke klikuar disketën hapet dialog - dritare në të cilën shkruhet emri i punimit të bërë, albumit.).

AKTIVITETET EVALUATIVE

Nxënësit i kthejnë faqet e albumit të përpunuar dhe i shqyrtojnë hartat dhe të dhënat e futura për disa nga pasuritë dhe bukuritë natyrore të vendlindjes së tyre dhe atdheut.

Treguesit e të arriturave

Nxënësi/nxënësjë numrojnë dhe përshkruajnë disa bukuri natyrore të vendlidjes së vet, komunës dhe Republikës së Maqedonisë.

Vërejtje:

Nëse në shkollë nuk ka mundësi të realizohet aktivitet në laboratorinë kompjuterike, mund të bëhet fletë e punës me hartë pa emra të Republikës së Maqedonisë dhe kërkesa për futjen e vendeve më të rëndësishme nga vendlindja dhe atdheu i tyre.

Fletë pune:

Bëni album prej 3 faqe: **“Bukuritë e vendlindjes”. Programi për kombinimin e informatave “Stripet”**

Nga proramimi për lojëra arsimore “Harta” inçizojeni hartën e R. së Maqedonisë. Hapeni programin për kombinimin e informatave “Stripet”.

1. Në faqen e parë vëndoni fotografinë e hartës së R. Së Maqedonisë.

a) Shkruani emrin e komunës tuaj (qytet, fshat). b) Emrin e lumit, malit në afërsi të vendlindjes.

2 Në faqen e dytë vëndoni fotografinë e hartës të Republikës së Maqedonisë.

a) Shkruane emrin e Malit Sharr.
b) Shkruane emrin e lumit tonë më të madh.

3. Në faqen e tretë vëndoni fotografinë e hartës së R. së Maqedonisë.


Lexojini me vëmendje fjalitë. Pastaj nga galeria e arteve (flutura) zgjedhni fotografi përkatëse për t’i treguar pasuritë dhe bukuritë natyrore të R. Së Maqedonisë:


a) Në Liqenin e Ohrit jeton peshku i njohur **pastërmka**.
b) Mali Sharr është i pasur me **drunjë gjethrënës dhe gjethmbajtës**.
c) Në Ohër ka shumë **ndërtime të vjetra si dhe përmendore** nga e kaluara.

Page 1



Page 2





TEMA : VENDLINDJA IME

Shembulli 10: Komuna ime

Qëllimet: nxënësi/nxënësja ta emërtojë komunën, të njihet me institucionet më të rëndësishme në të dhe të njihet se me secilën komunë udhëheq kryetari i komunës/prefekti.

Nocionet kryesore: komuna, kryetari i komunës.


Mjetet: strajca, lista me nocione.

Vendi i realizimit: klasë.

Rrjedha e aktiviteteve

AKTIVITETET HYRËSE

Loja: „Strajca magjike“. Nxënësit nxjerrin kartelat në të cilat janë të shkruara nocionet. Me zbulimin e tyre ata vijnë deri te nocioni *komuna* dhe njeriu i cili udhëheq me të. Nocioni shkruhet në letër poster / hamer, ndërsa rreth tij nxënësit i radhisin dhe ngjisin nocionet.



AKTIVITETET E MËSIMNXËNIES-MËSIMDHËNIES

Kryetarit të komunës për vizitë i kanë arritur mysafirë nga komuna fqinje. Ai dëshiron ti gostisë dhe t'ua prezantojë komunën në mënyrë sa më të mirë. Çka duhet të bëjë? Çka do t'iu tregojë mysafirëve, çka ka në qytetin/komunën tonë?

Çka do t'iu kishte interesuar mysafirëve? Çka ju do të kishit dëshiruar të shihni kur shkoni në vizitë në ndonjë qytet/komunë? Eja ti ndihmojmë kryetarit të komunës.

Nxënësit ndahen në grupe.

Grupi i parë i zgjedh dhe numëron objektet më të rëndësishme kulturore-historike në komunë.

Grupi i dytë i zgjedh bukuritë natyrore dhe të rralla në komunë.

Grupi i tretë i zgjedh ngjarjet më të rëndësishme në komunë.

Grupi i katërt: i zgjedh restorantet, shitoret, ëmbëltoret më të mira në komunë.

Secili në grup mendon, ndanë me të tjerët në grup, merret vesh dhe shkruan dhe krijon faqe e cila do të gjendet në broshurën e përbashkët të cilën do t'ia dërgojnë kryetarit të komunës.

AKTIVITETET EVALUATIVE

Secili grup zgjedh përfaqësuesin e vet i cili prezanton atë që kanë punuar para nxënësve tjerë. Nxënësit i përmbledhin punimet e tyre, i bashkojnë dhe me ndihmën e mësimit nxënësit bëjnë broshurë të cilën nxënësit do t'ia dërgojnë kryetarit të komunës në takimin e paralajmëruar me të.

Treguesit e të arriturave

Nxënësi nxënësja e mërton komunën e vet, numëron më shumë institucione në të dhe e di se me çdo komunë udhëheq prefekti i komunës.

TEMA: KOMUNIKACIONI

Shembulli 11: Llojet e komunikacionit

Qëllimet: nxënësi/nxënësja të njihet me llojet e komunikacionit, ngjashmëritë dhe dallimet mes tyre.

Mjetet: fotografi, fletë pune.

Nocionet kryesore: komunikacioni ujor, komunikacioni ajror, komunikacioni i thatë tokësor, vozitës, vozitës makine, pilot, marinar, kapiten;

Vendi i realizimit: klasë.

Aktivitetet paraprake: nxënësit mbajnë fotografi me mjete të komunikacionit.

Rrjedha e aktivitetit

AKTIVITETET HYRËSE

Me nxënësit zhvillohet bisedë për atë se ku kanë udhëtuar, me çka kanë udhëtuar dhe me çka më së shumti dëshirojnë të udhëtojnë.

AKTIVITETET E MËSIMDHËNIES-MËSIMNXËNIES

Mësimdhënësi iu lexon nxënësve dy strofat e para të vjershës “Eja të udhëtojmë”. Pastaj zhvillohet bisedë për komunikacionin ajror. Njoftohen dhe emërtojnë mjetet e komunikacionit nga fotografitë e vendosura në tavolinat e nxënësve. Bisedohet për atë se ku udhëtohet më këto mjete të komunikacionit, kush drejton ato, kush kujdeset për komoditetin gjatë udhëtimit të udhëtarëve. Pastaj lexohen dy strofat vijuese, gjithashtu, bisedohet për komunikacionin e thatë tokësor, me ç'rast

bëhet dallimi ndërmjet komunikacionit rrugor dhe hekurudhor, vozitësit dhe makinovozitësit. Pastaj me vargjet vijuese paralajmërohet “udhëtimi”, me komunikacion ujor. Emërtohen dhe dallohen mjetet e komunikacionit të komunikacionit ujor dhe bisedohet për atë se vaporin e drejton kapiteni.

AKTIVITETET EVALUATIVE

Mësimdhënësi iu ndanë nxënësve fletë pune për punë individuale. Aktiviteti i nxënësve në fletën e punës.

Treguesit e të arriturave

Nxënësi/nxënësja mund t'i emërtojnë dhe dallojnë mjetet e komunikacionit dhe njerëzit të cilët drejtojnë ato dhe disa nga të punësuarit.

Shtojcë: fletë pune nr. 9

Shtojcë: Vjersha „Eja të udhëtojmë”

- | | | |
|----|---|---|
| 1. | Eja të udhëtojmë
Gjithkund të shkojmë
në shtigje me yje
në qiell të fluturojmë | Aeroplanë janë të shpejtë
si shpendët në fluturim,
me to do të udhëtojmë
tërë botën do ta kalojmë. |
| 2. | Dhe kur sërish
nga qielli të zbresim
veturat të bukura
në tokë na presin. | Me autobus mundemi
gjithkah të shkojmë,
nëpër vendin tonë
me gëzim të qarkojmë. |
| 3. | Eja të udhëtojmë
dhe me anije të lundrojmë
Në Liqenin e Ohrit
peshqë të peshkojmë. | Dhe pastaj duhet
nga erdhëm të shkojmë
kujtime të bukura
në shtëpi të strehojmë. |

TEMA: KOMUNIKACIONI

Shembulli 12: Komunikacioni

Qëllimet: nxënësi/nxënësja t'i kontrollojnë njohuritë e fituara për komunikacionin.

Mjetet: fletë pune nr.10 për kontrollimin e njohurive.

Lloji i orës: kontrollimi i njohurive.

Vendi i realizimit: klasë.

Rrjedha e aktivitetit

AKTIVITETET HYRËSE

Mësimdhënësi i njohton nxënësit me qëllimin e orës dhe pastaj iu jep udhëzim të shkurtë për punën e tyre individuale në fletën e punës.

AKTIVITETET E MËSIMDHËNIES-MËSIMNXËNIES

Nxënësit janë aktivizuar në kërkesat e fletës së punës, kurse mësimdhënësi e përcjell punën e tyre.


AKTIVITETET EVALUATIVE

Nxënësit i përfundojnë aktivitetet dhe mësimdhënësit ia dorëzojnë fletat e punës.

Treguesit e të arriturave

Përgjigjet e nxënësve në fletën e punës për kontrollimin e diturive.

Fletë pune nr.1 Shkruaj në këto re emrat e më të afërmit tuaj familjar nga nëna dhe babai



Fletë pune nr. 2

Emri i nxënësit: _____

data: _____


Në vijën nën fotografinë shkruaje emrin e mjetit të komunikacionit dhe të drejtuesit të mjetit të komunikacionit. Njohtoni edhe disa të tjerë të punësuar në komunikacion.

LLOJET E KOMUNIKACIONIT

KOMUNIKACIONI AJROR

Mjetet e komunikacionit

Drejtuesi i mjetit të komunikacionit dhe disa nga të punësuarit






KOMUNIKACIONI I THATË TOKËSOR

Komunikacioni rrugor



Komunikacioni hekurudhor



KOMUNIKACIONI UJOR



Nëse të duhet ndihmë: (tren, vozitës, aeroplan, barkë, autobus, vozitësmachine, pilot, tren elektrik, vapor, helikopter, maun, marinar, kapiten, lokomotivë, automobil, gliser, balon, stjuardesë).

Fletë pune nr. 3

Verifikimi i njohurive nga njohja e mjedisit në klasën e III-të

Emri dhe mbiemri _____

data: _____

TEMA: KOMUNIKACIONI

Pyetje:

1. Kush janë pjesëmarrës në komunikacion?

2. Cili është roli i kolonës në komunikacion ?

3. Në qoftë se nuk ekziston trotuar, nga cila anë e rrugës lëvizin këmbësorët?


4. Çfarë shenje është semafori dhe për çka u shërben këmbësorëve?





5. Cilat lloje të komunikacionit të thatë tokësor ekzistojnë ?

Plotëso:

6. Emërto mjetet e komunikacionit në vijën që gjendet nën fotografinë:








7. Me  udhëhiqet _____ kurse, me  _____.

8. Shkruaj numrin adekuat nën shenjën: 1, 2 ose 3, dhe pastaj ngjyrosi shenjat e komunikacionit.



1. Fëmijë në rrugë
2. Ndalohet komunikacioni për këmbëtorë për këmbësorë
3. Spitali

9. Çfarë gabimi bën këmbësori në foto gjatë tejkalimit në kalim jo te drejtë?

foto1



10. Çka po ndodh në foton nr.2?

foto 2



Vlerësimi për të arriturat e nxënësit:

Mësimdhënësi: _____

LITERATURA

1. Adamčeska, S. (1996), Aktivna nastava, Legis: Skopje
2. Arnaudova, V. Naceva, B. Radevska, J. Damčevska-Ilievska, V. (000), Priodi kon vizuelno razmislvanje, BRO, Skopje
3. Bognar, L., Matijevic, M. (2002), Didaktika, školska knjiga, Zagreb
4. Dončovka, D. (), Metodika po zapoznavanje na prirodната i opshtestvenata sredina, Univerzitet „Sv. Kiril i Metodij“ - Skopje
5. De Zan, I. (2005), Metodika nastave prirode i drushtva, školska knjiga, Zagreb
6. Diklić, D., Bradić, D. (1980), Upoznavanje predškolske dece sa okolinom i praktikum upoznavanje prirode, PEV, Beograd
7. Grupa avtorov, (000), Opisno ocenuvanje, PZM - Skopje
8. Kamenov, E., Petrov, N. (), Metodika na vospitno-obrazovnata rabota so deca od predučilisna vozrast, Prosvetno delo, Skopje
9. Kamčevska, B. (00), Razvoj na programi i strategii za avtoindividualizacija na decata, Grafo B/S, Skopje
10. Kolonxovski, B. (00), Deteto istrazuvač na prirodната, Bitola
11. Čekor po čekor (00) Unapreduvawe na nastavata po matematika i zapoznavawe na okolinata od I do III oddelenie - Materijali za obuka
12. Lekić, D. (1991), Metodika razredne nastave, Nova prosveta, Beograd
13. Petrov, N. (1987), Deteto vo prirodната i okolinata, Detska radost, Skopje
14. Matić, R. (1990), Igre i aktivnosti dece, Nova prosveta, Beograd
15. Naceva, B. Mickovska, G., Popovski, K. (2001), Opisno ocenuvanje na postiganjata na učenicite od I, II i III odd. na osnovnoto učiliste, BRO - Skopje
16. M. V. Klarin (1995), Pedagogshka tehnologija vo nastavniot proces, Skopje
17. Mickovska, G. “Analitičko ocenuvanje na učeničkite proekti” Obrazovni refleksi - Skopje